

VLERE

REVISTË PËR FAMILJE DHE SHOQËRI

***Letër e hapur
Civilizimit
Euro-Perëndimor***

Liridon Miftari

***Metoda e Kurani
në fizioterapi***

***Jeta dhe vepra
e Dalip Frashërit***

***Vërtetim historik
i ngjarjes së Gadirit***



Letër e hapur Civilizimit Euro-Perëndimor

4




Urdhëresa E Imam Aliut për Pushtetaret e Mirë

6



Jeta dhe Vepra e Dalip Frashërit

12



Ultratingulli apo Mamografia

36

KRYEREDAKTORE:

Msc.Ikballe Berisha Huduti

ikballebh@gmail.com

www.ikballebh.com

Mob: +377 44 142 038

REDAKTORE:

Mr. Valentina Shala

REDAKSIA:

Mr. Iris Robaj

Dr. Emine Goxhuli

Fehmi Maliqi

Zehra Huduti

Adelina Rama

DESIGN:

MM

ADRESA:

Rr.Rrustem Statovci 25

Prishtinë 10000

E-mail: vlera.magazine@gmail.com

www.revistavlera.com

Botoi: Shtëpia Botuese

"Dielli Pas Reve"



YouTube

Dielli Pas Reve

SPONSORED BY:

THE
WORLD
FEDERATION
OF KHOJA SHIA ITHNA-ASHERI MUSLIM COMMUNITIES



NË VEND TË EDITORIALIT

NË KOHËN E TITOS

Autor : Ikballe Berisha Huduti



Ishin në kohën e Titos, para tij të Rankoviçit
Morën rrugën e muhaxhirit
Më të pasurit e shoqërisë
Që me djersë kishin punuar
Tokën e Shqipërisë

Ata ishin ndër të mirët
Që i dhanë bukë shoqërisë
Ata ishin më të devotshmit
Që i frikësoheshin Perëndisë

E ne të mjerët që mbetëm
Për sllavët ishim të pavlerë
Na zhveshën nga vlerat
Na bënë besnikë të panderë

Shoqet komuniste
Punonin për barazi
Shpërbleheshin nga Partia
Ato që largonin më shumë shami

Ndërsa gratë e ndershme, punëtore në shoqëri
Që mësonin shkencën e Tusit, Avicenës në shtëpi
Atyre u thoshin të prapambetura
Ngase nuk kishin funde, por mbanin shami

Nga uzina e Filigranit, ku arti gjallëronte
Nga kjo fabrikë e dashur, me kusht nga puna u larguan
Me qindra motra shqiptare u mbyllën në shtëpi
Kishte edhe prej tyre që shkelën nderin për dinarin e
Serbisë

Ata që e bënë tabi, Serbinë e Jugosllavinë
Ecën përpara, me librezë të kuqe të nënës parti
Ndërsa nënave tona, e gjyshes sime rahmetli
I njihnin si të prapambetura, mu siç na thonë tani

E gjyshërve të mi që nderin s'e larguan
Që mua Rankoviçi gjyshin në borë ma ka shkatërruar
Se Ramadani ka alltën e duhet ta japë për Serbinë
E Kasami ka armë e allti, ato nuk i takojnë atij

Baballarët tanë me gjoks kanë luftuar
Kanë humbur pozitat që i kanë merituar
E kishin në shënjestër çdo lëvizje të tij
E nënçmuan, e shtypën për hir të Partisë

Ne fëmijët e asaj kohe i këndonim Partisë
Në orët e gjuhës serbe këndonim me melodi:

“Godine su prosle pune muka
Ginulo se zaslobodunjemo
Ili s pjesmom u mesto jauka
DruzeTito mi ti se kunemo(4 herë)

Të gjithë ata që iu betuan Titos dhe Partisë
Kishin shkollimin më të mirë në të gjithë Jugosllavinë
Ndërsa ne që besonim, fshehurazi agjëronim
Na ndiqnin e torturonin, jemi ballistë na thonin

Qoftë e kaluar, kurrë më e trazuar
Por sot çfarë duhet punuar?
Ende të vuajmë si të fobuar?

Antivlerat po i lëvdojnë, të keqen të mirë po na bëjnë
Me elitë të degjeneruar, kulturë janë duke na treguar
Modernizëm na deklarojnë
Hedonizmin e lartësojnë
Gazetarët e mediave tona këtë punojnë
E bukën haram në shtëpi e çojnë

Merre timonin e kohës në dorë
Ecë përpara me kohë
Se Zoti betohet me të
Ke kujdes se çfarë punon
Më mirë me barkun bosh
Se sa t'i ndihmohet të keqes për disa grosh

Ti je Ballkan, ti je Europë
O Shqipëri, e lumja Iliri
Askush nuk mund të të mashtrojë ty
Kemi Fishtën e Naim Beun
Që ia dhanë besën Skënderbeut
Të cilët kombit i dhanë jetë
Pa komb e fe nuk ka atdhe
Se kombi dhe feja janë mbjellë tek ne

Se shqiptari di të falë por kurrë të harrojë
Prandaj le të jetë mësim për të gjithë ne
E mos të mashtrojmë njëri tjetrin me demokraci
Se ne nuk hamë bar, o vëllezërit e mi
Se nipat e partisë, sërish enden në shoqëri
Por bijtë e Skënderbeut nuk kanë dert për fe e për parti

Ata janë gjak shqiptari, gjak krishteri e muslimani
Që trojet tona do t'i bashkojnë

Me Shpëtimtarin e Kohës, Imamin Mehdi.



LETËR E HAPUR CIVILIZIMIT EURO-PERËNDIMOR

Autor : Liridon Miftari

Kemi përparuar shumë në mjekësi, teknologji, arsim dhe standardi ekonomik është përmirësuar dukshëm. Njerëzimi ka shkuar përpara dhe është e vërtetë, por është një marrëzi që nga gjithë ky zhvillim, njerëzimi në përgjithësi jo vetëm ka stagnuar, mirëpo është kthyer shumë prapa, ka mbetur “primitiv” në gjënë më të rëndësishme që e identifikon si genie njerëzore. Dhe ai është morali i tij.

Teksa po shfletoja nëpër internet për “Woman’s fashion, clothing through years” vëreja diçka vërtet interesante. Në botën perëndimore, deri pas Luftës së Parë Botërore, një femër që ekspozonte më shumë se zogun e këmbës, quhej femër e lirë, apo femër e bordellove. Në vitet e 20’ta zbulimi i këmbëve deri të gjuri dhe zbulimi i krahëve ishte normal, dhe nuk etiketohej si femër e bordellove. Në vitet e 50’ta u normalizua ekspozimi i gjinjve dhe po ashtu ekspozimi i këmbëve ishte më i theksuar. Në vitet e 80’ta u normalizua ekspozimi i tërë trupit të femrat dhe vetëm vijat më intime të trupit nëse ekspozoheshin merrej si diçka e pamoralshme dhe e tepruar. Ndërsa që nga vitet e para të shekullit tonë, tendencat e aktoreve dhe këngëtareve të famshme me veshjet e tyre, tentojnë që këtë “normalizim” të “veshjes së femrës” ta çojnë edhe më tej, ose thënë shkurt, një veshje totalisht e zhveshur nëse kanë sukses parashikoj se ecja nudo nëpër plazh do të jetë një gjë normale.


Bota perëndimore pati zhvillim ekonomik dhe nga ana tjetër e botës u pa në këndin se edhe ne duhet të bëhemi krejtësisht si ata. Dhe ishte po kjo botë perëndimore që shihte si inferiore gjithë qytetërimet dhe as që mendoi se ky civilizim perëndimor kishte çka të merrte nga të tjera civilizime dhe kishte çka të merrte, por JO, gjithçka tjetër në shikimin e tyre ishte e prapambetur dhe shihej me përbuzje. U kuptua botërisht se ose do të bëhemi si perëndimi ose do të jemi të prapambetur.

Bota perëndimore vazhdoi më tutje. Me krenarinë se ishte civilizim i të drejtave dhe lirive të nje-

riut, dha aq shumë liri, sa që nganjëherë ia vlen të mendohet thellë në mënyrë filozofike se çka është liria? A është ajo e dobishme për njerëzimin? A ia pa hajrin njerëzimi këtyre lirive që ata promovojnë me aq pompozitet si homoseksualizmi, legalizimi i drogës, zhveshja e moralit njerëzor? A janë këto vlera? Apo duhet dikush nga njerëzit që u brumosën nga civilizimet e tjera t’i dalë ballë këtij civilizimi Euro-Perëndimor e t’i thotë “më fal, jo për gjithçka e keni mirë, ne mendojmë ndryshe” dhe nëse e them këtë a do të quhem unë si i prapambetur, primitiv, ekstremist, terrorist? Besoj se prej euro-perëndimorëve do të quhem i tillë. Por fundi i fundit edhe unë kam lirinë e të shprehurit.

I dashur civilizim Euro-Perëndimor. Gjeografikisht jam evropian, pra jam anti(vlerë) e juaja. Nga gjaku jam shqiptar dhe si i tillë në Evropë sipas të dhënave historike jemi nga popujt e parë të qytetëruar në tokën tuaj, pra ia vlen të dëgjoni mendimin tim. Jam mysliman, dhe thirrrem në vlera islame sepse kjo është feja ime dhe mënyra e jetesës, andaj pres që ta respektoni edhe këtë. Nëse thirrreni në atë se Evropa është e krishterë dhe s’ka vend për Lindjen në Evropë, ua përkujtoj se sa është aziatik Jezusi po aq aziatik është edhe Muhamedi. Njëri ishte me nacionalitet hebre, e tjetri arab. Pra, në Evropë paska vend edhe për Lindjen.

Do të dal për pak nga sistemi i vlerave të mia dhe do të supozoj disa gjëra. Nëse e gjithë bota do të ishte një çerdhe homoseksualësh, përfundoj se njerëzim do të zhdukej për 60 vjet. Sepse një gej s’do të pranonte kurrë të shkonte me një femër, dhe një lezbike me një mashkull dhe kështu riprodhimi do të ishte i pamundur. Nëse njerëzit do të kryenin mardhënie me kafshë, i njëjti fat do ta priste njerëzimin, zhdukje totale. Nëse thirrremi në atë se nëse dy persona me gjini të njëjtë kanë vendosur të kenë mardhënie seksuale, kjo është liri e tyre dhe përderisa e kanë bërë me vetë dëshirë kjo s’bën ta pengojë askënd. Në këtë logjikë, nëse një nënë vendos të ketë mardhënie me të bijtë



e saj, ose një vëlla me një motër të tij, një baba me një bijë, edhe kjo s'duhet të na pengojë. Por... Ups... Njeriu paska diçka që e dallon shumë nga çdo krijesë e tij. Ai është TURPI dhe MORALI. Pyes këtë civilizim të cilit po i drejtohem me këtë letër, përveç lirisë a e njihni turpin dhe moralin? Kisha pasur dëshirë të di si i identifikoni ato? Apo sipas jush turpi dhe morali nuk janë vlera njerëzore?

Kthehem në sistemin e vlerave të mia. Unë jam shqiptar mysliman. Kurrë në historinë e popullit tim nuk ka pasur homoseksualë, gjithë personalitetet historike shqiptare që kombi identifikohet me ta, kishin familje të shëndoshë dhe të kompletuar. Pra si shqiptar, këtu s'ka vend homoseksualizmi dhe marrëdhëniet e tjera të fëlliqura. Si mysliman e di se Allahu të cilin unë e besoj për Zotin tim, dënoi ashpër një popull që praktikoi këtë gjë. Ai është populli i Lutit që u shfaros nga Allahu për shkak të po këtij mëkati. Shikuar nga ky aspekt, homoseksualizmi si "vlerë" i lufton vlerat e mia, dhe unë po kundërpërgjigjem dhe sa i përket tolerancës, mund t'ua them hapur se nuk jam tolerant kur vjen në pyetje ruajtja e nderit të familjes sime, sepse familja është më e shenjtë se çdo gjë tjetër. Pra sipas sistemit të vlerave të mia kurrë kjo dukuri e fëlliqur s'ka vend në vendin ku unë jetoj. E nëse ju euro-perëndimorët, na vini parakushte që të hymë në bashkësitë e juaja vetëm atëherë kur t'i pranojmë këta "njerëz", unë ju them: "Ikni, vërtet unë jam shumë më i pastër se ju, s'ka ç'më duhet

të jem në një bashkësi të fëlliqur që mbron ide të fëlliqura. Ne kemi moralin dhe vlerat tona, ne jemi më të civilizuar se ju, ju jeni të prapambeturit".

Keni zbuluar vlerat kombëtare. Lufta e Dytë Botërore njihet si lufta më e përgjakshme në tërë historinë e njerëzimit, si faj i nacionalizmit të tepruar. Keni zbuluar bombën atomike si shkak i mbrojtjes nga meteorët. Asnjë meteor nuk ra, por u godit Hiroshima dhe Nagasaki nga bomba atomike, ata mund të ishin gjithçka, por jo meteorë dhe ende sot bombat atomike paraqesin rrezik të përherëshëm për zhdukjen e jetës në tokë. Keni arritur ta zhvillonin standardin ekonomik dhe jetësor, por numrin e vetëvrasjeve, numrin e psikopatëve që rriten çdo ditë në numër, dhe vrasjen e fëmijëve nëpër shkolla nuk po mundeni ta ndalni. Keni arritur ta "emanciponi" femrën por s'mund ta ndalni përdhunimin dhe prostituimin e saj, dhe siç dihet për përdhunime dhe prostituime jeni në majat e listave të shteteve në botë.

Të gjitha këto i gëlltitëm disi, por këto "vlerat e reja" që po na i servoni s'mund t'i kapërdijmë më. Merruni me problemet e juaja rreth moralit dhe turpit që janë të shumta dhe na lini neve me probleme të moralit dhe turpit, ne siç duket kemi më pak. Dhe kur të më thoni se një homoseksuali apo një homoseksualeje ia pa hajrin i gjithë njerëzimi, atëherë kjo letër e imja është e pavlerë.

URDHËRESA E IMAM ALIUT

PËR PUSHTETARET E MIRË

“...sepse njerëzit janë dy llojesh: ose janë vëllezërit e tu të një besimi ose të barabartë me ty për nga krijimi...”

Kjo urdhëresë u përpilua në vitin 38 pas Hixhrit nga kalifi i katërt i shtetit islam, Ali ibn Ebu Talibi (pagja qoftë mbi të), kur ai e emëroi Malik el-Eshtherin si guvernator të krahinës së Egjiptit. Në të, Imam Aliu i shtron principet e qeverisjes së vërtetë islame, duke i shpjeguar hollësisht detyrimet e shtetit ndaj klasave të ndryshme të qytetarëve të tij dhe mënyrën më të përshtatshme, për t'i përmbushur këto detyrime. Ky dokument i pashoq, që lirisht mund të quhet një manifest i qeverisjes së vërtetë islame, i ngërthen në vete të drejtat themelore qytetare dhe njerëzore, duke e shpallur barazinë e të gjithë njerëzve:

“...sepse njerëzit janë dy llojesh:
ose janë vëllezërit e tu të një
besimi ose të barabartë me ty
për nga krijimi...”

Trembëdhjetë shekuj pas Imam Aliut, i njëjti princip do t'i shpallej sërish botës në nenin e parë të Deklaratës së Përgjithshme të të Drejtave të Njeriut:

Të gjithë njerëzit lindin të lirë
dhe të barabartë në dinjitet dhe
në të drejta. Ata kanë arsye dhe
ndërgjegje dhe duhet të sil-
len ndaj njëri tjetrit me frymë
vëllazërimi...

2 Marrë nga faqja zyrtare e Komisionerit të lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut. www.ohchr.org



Ky dokument s'është veçse një dëshmi tjetër e qartë e universalitetit të Islamit dhe e madhësisë së tij, si porosia e fundit hyjnore për njerëzimin.

Lëvdatat më të bukura i takojnë Zotit të botëve!
Pagja qoftë mbi të Dërguarin e Tij, Muhammedin
dhe mbi familjen e tij të dëlirë!

Përmbajtja e urdhëresës Përkthimi i këtij dokumenti është bërë duke u mbështetur në versionin e përcjellur në veprën “Nehxhul Belaga”, të përpiluar nga Sejjid Ebu'l-Hasan Muhammed ibn Husejn er-Radi, në shekullin e dhjetë të erës sonë në gjuhën shqipe “Shtegu i elokuencës”. Kjo letër përcillet si letra e 53-të, në pjesën e dytë të librit, ku janë përmbledhur letrat e Imam Aliut. Me emrin e Zotit, Bamirës dhe Mëshirues...

Kjo është urdhëresa e robit të Zotit dhe Prijësit të Besimtarëve, Aliut, për Malik ibn el-Harith el-Eshtherin, me rastin e emërimit të tij si guvernator i Egjiptit, për t'i mbledhur tatimet e këtij vendi, për t'i luftuar armiqet e tij, për t'u kujdesur për punët e popullit dhe për ta përmirësuar gjendjen e tyre. Ai i urdhëron t'i druhet e t'i bindet Zotit dhe ta ndjekë atë, që është urdhëruar në Librin e Tij, qoftë nga veprat e detyrueshme, qoftë nga ato vullnetare, pa të cilat njeriu s'bëhet dot i virtytshëm dhe s'mund të mbrohet nga e liga. Ai gjithashtu i urdhëron ta ndihmojë Zotin e Madhëruar, me zemrën, me duart e me gjuhën e tij sepse Zoti, Emrat e të cilit janë të shenjtë, e merr përsipër t'i ndihmojë gjithkujt që i ndihmon Atij dhe ta mbrojë gjithkë që Atë e përkrah. Ai i urdhëron që t'i sundojë dëshirat e tija dhe të përmbahet kur ato të shfaqen, sepse, po të mos jetë mëshira e Zotit, nefsi (egoja) gjithnjë anon kah e liga.

**Cilësitë e një guvernatori dhe
përgjegjësitë e tij**

Dije pra, o Malik, se po të dërgoj në një tokë, ku ka patur sundues të tjerë para teje, si të drejtë ashtu

edhe shtypës. Tani njerëzit do t'i ndjekin veprimet e tua, njësoj siç i ndiqje ti veprimet e atyre para teje. Njësoj siç i gjykoje ti ata, edhe njerëzit kanë për të të gjykuar ty tani. Dije se të virtytshmit njihen nga fjalët e mira, që Zoti i vendos në gjuhët e robërve të Tij. Andaj, le të jenë veprat e mira, pasuria më e vlefshme që do ta mbledhësh. Nënshtroni dëshirat e tua! Përmbaju dhe mbaje zemrën tënde larg të ligës!

Mësoje zemrën tënde të jetë e mëshirshme dhe e dhembshur ndaj popullit. Mos u qëndro mbi krye si një bishë e uritur, sepse njerëzit janë dy llojesh: ose janë vëllezërit e tu të një besimi ose të barabartë me ty përnga krijimi. Ata domosdo do të mëkatojnë e do të bëjnë gabime, pa dashur ose me qëllim. Ti tregohu falës dhe i mëshirshëm, njësoj siç do të doje Zoti të ishte i mëshirshëm me ty. Siç je ti i vendosur në krye të tyre, dije se Prijësi (Imami) yt është mbi ty dhe Zoti është i vendosur mbi të. Zoti t'i ka lënë në duar punët e këtyre njerëzve dhe po të sprovon nëpërmjet tyre.

Mos u mundo ta sfidosh Atë sepse nuk ke fuqi për t'iu kundërvënë fuqisë së Zotit dhe nuk mund të jetosh pa mëshirën dhe pa faljen e Tij. Mos ki turp të falësh dhe të jesh i mëshirshëm në të dënuar! Mos vepro me ngut gjatë zemërimit, kur mund të ketë ndonjë rrugëdalje tjetër! Mos thuaj “mua më është dhënë autoriteti dhe duhet të më bindeni kur të urdhëroj...” sepse kjo gjë krijon dyshim në zemra, e dobëson fenë dhe e çon njeriun drejt shkatërrimit. Nëse pozita, që të është dhënë, krijon krenari dhe mendjemadhësi tek ti, atëherë shihe madhështinë e Zotit përballë teje dhe fuqinë e Tij, të cilën ti s'e ke as mbi vetveten. Kjo do ta shkatërrojë mendjemadhësinë tënde, do ta largojë arrogancën dhe do t'ta rikthejë urtësinë, që e ke humbur.

Ki kujdes të mos e krahasosh veten me Zotin përnga madhështia dhe të mos e ngjasosh fuqinë tënde me fuqinë e Tij, sepse Zoti e nënshtron çdo sfidues dhe e çnderon secilin, që është mendjemadh. Ji i drejtë me njerëzit, për hir të Zotit! Mos bëj padrejtësi, kur të bëhet fjalë për të afërmit e tu dhe për ata, të cilët i ke më për zemër, sepse po e bërë këtë, do të jesh shtypës. E kur dikush i shtyp krijesat e Zotit, në vend të tyre, Zoti bëhet armiku i tij dhe kur Zoti është armiku i dikujt, Ai ia prish çdo punë. Një njeri i tillë do të mbetet armik i Zotit derisa të dorëzohet dhe të pendohet për atë që ka bërë.

Asgjë nuk i largon të mirat e Zotit dhe nuk e përshpejton dënimin e Tij, sa këmbëngulja në shtypje, sepse Zoti e dëgjon lutjen e të shtypurve dhe nuk i lë shtypësit të shpëtojnë.

Sundimi duhet të jetë në të mirë të të gjithë njerëzve

Mënyra jote e të vepruarit duhet të jetë ajo, që është e barabartë ndaj të gjithëve, më gjithëpërfshirëse në drejtësi dhe gjithnjë në të mirë të popullit. Pakënaqësia në mesin e njerëzve të thjeshtë e përkeqëson gjendjen, ndonëse paria mund të jetë e kënaqur. Në anën tjetër, pakënaqësia e disa personave nga të parët e vendit mund të arsyetohet, përderisa populli i thjeshtë është i kënaqur me gjendjen. Në mesin e njerëzve, s'ka ngarkesë më të madhe për një prijës gjatë pages, njerëz më të padobishëm gjatë konflikteve, më të pakënaqur nga barazia, më të dyfytërshëm në të kërkuarin e favoreve, më pak mirënjohës ndaj bujarisë, më pak të kënaqur me arsyetimet e tua gjatë mosdhënies dhe më të paqëndrueshëm gjatë trazirave sesa pjesëtarët e parisë. Dije se njerëzit e thjeshtë janë shtylla e fesë, fuqia e muslimanëve dhe mbrojtja e tyre kundër armikut. Andaj kujdesu për punët e tyre dhe ji miqësor me ta!

Njeriu më i lig në mesin e atyre që i sundon dhe më i largëti prej teje, duhet të jetë ai, i cili i gjurmon mangësitë e njerëzve të tjerë. Të gjithë njerëzit kanë mangësi dhe prijësi i tyre është ai që duhet t'i mbulojë ato. Mos i përhap mangësitë dhe gabimet e tyre të fshehta sepse detyra jote është ta korrigjosh atë që është e hapur. Lëre në duart e Zotit atë, që është e fshehur prej teje!

Mbuloi mangësitë e tyre, aq sa mundesh dhe Zoti do t'i mbulojë ato mangësi tuajat, të cilat do të doje të mbeteshin të pazbuluara. Zgjidhe çdo nyje urrejtjeje mes njerëzve dhe parandaloi armiqësitë e mundshme mes tyre. Në çështjet që mbahen fshehur prej teje, bëhu sikur nuk di gjë! Mos u ngut për t'i përkrahur fjalët e thashethemexhinjëve në lidhje me njerëzit, sepse ndonëse mund të duken si këshilltarë të sinqertë, këta njerëz janë gjithnjë mashtrues.

Në lidhje me këshilltarët

Mos u këshillo me një koprrac, që s'të lë të jesh bujar dhe që të tremb gjithë kohës nga varfëria. Mos u këshillo as me ndonjë frikacak, që të bën përherë të ndihesh i dobët dhe as me ndonjë lakmitar, që bën të të duket e bukur mbledhja e pasurisë. Ndonse koprracia, paburrëria dhe lakmia janë tre vese të ndryshme, të gjitha burojnë nga mosnjohja e mjaftueshme e Zotit.

Këshilltari më i keq për ty është ai, i cili ka qenë këshilltar i prijësve të ligë para teje dhe që ka mar-

rë pjesë në mëkatet e tyre. Njerëzit e tillë s'duhet të jenë ndër këshilltarët e tu, sepse ata janë bashkëveprues të mëkatarëve dhe vëllezër të shtypësve. Në vend të tyre, mund të gjesh të tjerë, që janë të aftë dhe me ndikim si këta të parët, por që kurrë s'i kanë ndihmuar shtypësit dhe as mëkatarët në mëkatet e tyre. Të tillët, më së paku të hapin telashe dhe të përkrahin më së shumti. Ata gjithmonë do të jenë të kujdesshëm për ty dhe indiferentë ndaj të tjerëve. Andaj, bëji këta njerëz miqtë e tu më të afërt, qoftë në publik, qoftë në jetën private.

Për ty, më i miri prej tyre është ai që t'i thotë hapur të vërtetat dhe që s'të përkrah në vepra të tilla, të cilat Zoti nuk ua lejon miqve të Tij, ndonëse ti mund të dëshirosh të veprosh në atë mënyrë. Shoqërohu me njerëz të singertë, që i druhen Zotit! Pastaj mësoji mos të të lëvdojnë për veprat që s'i ke bërë, sepse teprimi në lëvdata krijon krenari dhe të çon drejt mendjemadhësisë.

Të virtytshmit dhe të ligët s'duhet të jenë të barabartë në sytë e tu, sepse kjo do të shkaktoje largim të të virtytshmive nga virtytet dhe vazhdim të të ligëve në të liga. Gjithkë mbaje në pozitën që e meriton! Dije se gjëja më e dobishme për të lënë përshtypje të mirë tek populli, është të sillesh butë me ta, t'ua lehtësosh vuajtjet dhe të mos u sjellësh telashe të padurueshme. Duhet të lësh përshtypje të mirë tek njerëzit, sepse mendimi i tyre i mirë për ty, ka për të të shpëtuar nga shumë probleme. Ki besim tek njerëzit, që u ke bërë mirë dhe që i ke sprovuar në vështirësi dhe ruaju nga njerëzit, të cilëve u ke bërë keq!

Mos i ndrysho ato tradita, që të parët e popullit i kanë ndjekur dhe që kanë mundësuar një unitet mes njerëzve e një përparim të tyre. Mos krijo risi duke i shkatërruar këto tradita të mëparshme, sepse atëherë, shpërblimi i atyre që i kanë nisur do të vazhdojë por dënimi për prishjen e tyre do t'të mbetet ty mbi supe. Gjithnjë bisedo me dijetarët dhe këshillohu me të urtit, që të mund t'i përmirësosh vendet nën sundimin tënd dhe të vazhdosh në atë vijë, në të cilën paraardhësit e tu kanë qenë të vendosur.

Klasat e ndryshme të njerëzve

Dije se populli përbëhet nga klasa të ndryshme, të cilat mund të përparojnë vetëm me ndihmën e njëra-tjetrës. Ndër to është ushtria e Zotit, pastaj nëpunësit, gjykatësit dhe paguesit e tatimit për kokë (xhizje) e të tatimit të tokës (haraxh) nga mesi i jobesimtarëve të mbrojtur nga Islami. Pastaj janë muslimanët e thjeshtë, tregtarët dhe zejtarët dhe klasa më e ulët e të varfërve dhe nevojtarëve. Zoti e ka caktuar hisen e secilit grup dhe i ka vendosur në Librin e Tij dhe në Traditën e Profetit, rregullat dhe kufizimet në lidhje me secilin prej tyre.

Me vullnetin e Zotit, ushtria është kështjella mbrojtëse e popullit, stolia e sunduesit, fuqia e fesë dhe mjeti për të siguruar paqen. Populli nuk mund të ekzistojë pa të dhe në anën tjetër, ushtria mund të mirëmbahet vetëm me pjesën e tatimeve që është e caktuar për të dhe që i mundëson të luftojë kundër armikut, të përparojë gjithë më tepër dhe t'i përmbushë nevojat e veta. Këto dy grupe (ushtria dhe populli i thjeshtë) nuk mund të ekzistojnë pa një grup të tretë, që përbëhet nga gjykatësit, zyrtarët dhe nëpunësit e kategorive të ndryshme, që merren me mbledhjen e tatimeve, e ruajnë rendin dhe e sigurojnë paqen mes grupeve të ndryshme të shoqërisë.

Dhe të gjithë këto grupe nuk mund të ekzistojnë pa tregtarët dhe zejtarët, të cilët i sigurojnë gjërat e nevojshme për ta, krijojnë tregje dhe u mundësojnë njerëzve, të mos merren vetë me sigurimin e gjërave të nevojshme për jetesë. Më në fund është klasa më e ulët, e përbërë nga të varfërit dhe nevojtarët, përkrahja dhe ndihma ndaj të cilëve është një detyrim sepse të gjithë kanë hise në begatitë e Zotit. Secili grup ka të drejta mbi prijësin, në varësi prej nevojave të veta. Një prijes nuk mund t'i përmbushë detyrimet ndaj tyre, veçse me ndihmën e Zotit dhe duke e stërvitur veten gjithë kohës, për t'i qëndruar besnik të drejtës dhe për të duruar çdo vështirësi.

Modifikuar nga Redaksia VLERA , teksti origjinal në www.dielli.net



**"...sepse njerëzit janë dy llojesh:
ose janë vëllezërit e tu të një besimi
ose të barabartë me ty për nga krijimi..."**

Ehli Bejti në hadithe

*“Në mesin tuaj, Ehli Bejti im është
sikur dera e shpëtimit.*

*Çdokush që hyn përmes asaj dera
është besimtar, dhe kush del prej saj,
është jobesimtar”.*



Huazuar nga libri dorëshkrim: “Ehli Bejti në Kuran”, autor: Enis Emir.

Kur e lexojmë historinë, vërejmë se ummeti është sjellë në mënyrë të vrazhdë dhe tradhtare kundrejt Ehli Bejtit mbas të Dërguarit (paqja qoftë mbi të dhe familjen e tij). Se sa i kanë dhënë rëndësi sahabët e shquar zotërisë së Ehli Bejtit, Hazret Imam Aliut, mund të shihet qartë. Ata janë dhënë mbas nefsit të tyre dhe dashuria ndaj kalifatit triumfoi mbi ta. Ata e kishin kryer këtë punë në mes veti pa i lajmëruar apo kërkuar leje nga Ehli Bejti. Ndërsa, testamenti i të Dërguarit (pqmtf) ishte i qartë dhe i kuptueshëm për të gjithë. Rruga e vetme e shpëtimit mbas tij është Ehli Bejti. Sikur të kishte pasur ndonjë rrugë tjetër, a do të kishin shpëtuar edhe ata që nuk kishin hipur në anijen e Nuhut (paqja qoftë mbi të)? Çka do të thotë hipja në anijen e Ehli Bejtit?

Kjo do të thotë nënshtrimi ndaj urdhrave dhe ndalesave të tyre; duke qenë ata prezentë, mos të dalësh përpara tyre dhe duke i pasur ata afër, mos të kërkosh këshilla prej të tjerëve. Thjesht, braktisja e tyre do të thotë braktisje e të Dërguarit (pqmtf) dhe nënshtrimi ndaj urdhrave të tjetrit. Kur ta shikojmë gjendjen e ummetit mbas të Dërguarit (pqmtf) do të vërejmë se më së shumti i përngjan përmbysjes. Urrejtja dhe armiqësia që ishte fshehur nëpër gjokse përnjëherë shpërtheu jashtë dhe

kishte shkuar aq larg saqë gjendja kishte mbërritur deri aty që të digjet shtëpia e Ehli Bejtit. Kjo është një e vërtetë që sikur të kishte mbetur besnik ummeti testamentit të të Dërguarit (pqmtf), nuk do të kishte mbetur vend për mospajtime. Nëse shkojmë më larg se ky përfundim logjik atëherë nuk mund të paramendojmë se i Dërguari (pqmtf) e ka lënë krye në vete ummetin. Pra, çdo musliman që ka besim duhet që të mbahet për anijen e Ehli Bejtit. Në të kundërtën, ummeti do të fundoset edhe më shumë në mospajtime e kundërshtime. Hadithin e nderuar e përcjellin këta dijetarë:

- Hejthemi në librin “Mexhma’uz-Zevaid”;
- Tabarani në librin “Mu’xhem”;
- Hakim en-Nishaburi në librin “Mustedrek”;
- Ibni Haxher el-Hejtemi në librin “Savaik’ul-Muhrika”;
- Ibn Asakir në librin “Tarih Medinet’ud-Dimeshk”;
- Sujuti në librin “Xhami’us-Sagir”;
- Ebi Nu’ajm el-Isfahani në librin “Hiljet’ul-Evlja”;
- Mutteki el-Hindi në librin

“Kenz’ul-Ummal”;

- Hatib el-Bagdadi në librin “Tarih Bagdad”;

- Muhib et-Tabari në librin

“Zahair’ul-Ukba”;

- Munavi në librin “Kunuz el-Hakaik”;

- Darekutni në librin “Efrad”;

dhe në shumë libra tjera.

*Në lidhje me hadithin e lartpërmendur
i Dërguari (pqmtf) ka thënë:*

*“Në mesin tuaj, Ehli Bejti im është si-
kur dera e shpëtimit. Çdokush që hyn
përmes asaj dera është besimtar, dhe
kush del prej saj, është jobesimtar.”*

Në këtë hadith është bërë e qartë domosdoshmëria e lidhjes me Ehli Bejtin. Lidhja e përgjithshme e ummetit me Ehli Bejtin është prej çështjeve të fesë dhe të besimit. Kjo nuk është një çështje e zgjedhjes së lirë së njeriut. Çdokush që ka besim këtë duhet ta qartësojë përmes lidhshmërisë së besimit të tij me ata. Si mund të flasim për lidhshmërinë e një muslimani për ata kur nuk e njeh identitetin e tyre? Dhe, çka është më e keqja, mjerë për ata që ende mundohen të na bindin se i duan dhe se janë të lidhur për Ehli Bejtin por që kanë mbetur si shikues gjatë vrasjes mizore të tyre! Si mundet njeriu që ta lë të dashurin e tij që të vritet? Sigurisht që do të vijë dita kur do të japin llogari ata që ende mundohen t’i mbulojnë lojërat që u janë luajtur Ehli Bejtit. Askush të mos dyshojë për atë se nuk do t’i arrijë ata dënimi i ashpër i Allahut.

Hadithi 2: Njëri prej sahabëve, Zejd ibn Thabiti, ka thënë: E kam dëgjuar nga i Dërguari i Allahut (pagja qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij): “Shkoni mbas Ehli Bejtit tim, mos kaloni para tyre, përndryshe do të shkatërroheni! As mos u mundohuni t’i mësoni ata sepse ata janë më të dijshtëm se ju!”

Në këtë hadith na tregohet haptas për epërsinë e diturisë së Ehli Bejtit, por shumica e muslimanëve nuk kanë marrë prej tyre asnjë dituri dhe këtë vazhdojnë ta bëjnë ende. Ne nuk mund të dimë arsyen e kësaj shkuarjeje të verbër të njerëzve në shkatërrim! Është një realitet i hidhur se shumica e librave të tefsirit ose të haditheve sunnite qëndrojnë larg prej diturisë së Ehli Bejtit dhe përmbajnë shumë pak njohuri për ata. Duke pasur përpara një kanosje të qartë të të Dërguarit (pqmtf) ne nuk mund të vijmë në ndonjë përfundim tjetër përveç kësaj: braktisja e Ehli Bejtit është bërë vetëm për arsyen e arritjes së mbretërisë së kësaj bote.

Ndërsa, ne nuk besojmë se kanë guxim që t’i hynë kësaj pune ata që i besojnë llogaridhënies në Ditën e Gjykimit. Po mirë, ajo kohë e kaluar nuk është më, por nuk mund të kuptojë inatin e dijetarëve të ditëve të sotit. Për hir të cilës dashurie nuk mund ta pranojnë rrugën e Ehli Bejtit? Hadithin e përcjellin këta dijetarë:

- Tabarani në librin “Mu’xhem’ul-Kebir”;

- Mutteki el-Hindi në librin “Kenz’ul-Ummal”;

- Ibni Haxher el-Hejtemi në librin

“Sava’ik’ul-Muhrika”;

- Hejthemi në librin “Mexhma’uz-Zevaid”;

- Sujuti në tefsirin “Durr’ul-Menthur”.

Hadithi 3: I Dërguari i Allahut (pqmtf) ka thënë: **“Dashuroni Allahun për hir të begative që ju jep Ai. Mua më dashuroni për hir të Allahut dhe Ehli Bejtin tim dashuroni për hir të dashurisë ndaj meje!”**

Hadithin e përcjellin këta dijetarë:

- Ebu Isa et-Tirmidhi në librin “Sahih”;

- Hakim en-Nisaburi në librin “Mustedrek”;

- Ebu Nu’ajm el-Isfahani në librin

“Hiljet’ul-Evlja”;

- Mutteki el-Hindi në librin “Kenz’ul-Ummal”;

- Hatib el-Bagdadi në librin “Tarih Bagdad”;

- Ibn’ul-Ethir el-Xhezeri në librin “Usd’ul-Gabah”;


- Sujuti në tefsirin “Durr’ul-Menthur”;

- Tabarani në librin “Mu’xhem’ul-Kebir”;

- Bejhaki në librin “Shu’abul-Iman”.

I Dërguari (pqmtf) na ka shpjeguar shumë bukur përparësinë e dashurisë ndaj tij. Për çdo mendje të shëndoshë duhet të jetë e qartë veçantia dhe vlera e lidhjes së dashurisë ndaj Ehli Bejtit, që duhet të burojë nga dashuria për Allahun dhe pastaj përmes dashurisë ndaj të Dërguarit (pqmtf) të dashurohet edhe Ehli Bejti. Pra, të dashurosh Ehli Bejtin do të thotë të dashurosh Allahun dhe të dashurosh të Dërguarin (pqmtf), por kjo dashuri duhet të jetë e singertë dhe nga zemra. Sepse, ai që e dashuron Allahun përmes gënjeshtreve, padyshim që nuk e ka dashur Atë dhe zemrat e këtyre njerëzve i di mirë Allahu. Ne njerëzit nuk e dimë se çka përmbajnë zemrat e njerëzve dhe dashurinë e njerëzve të tillë e masim me vlera tjera. Dashuria e singertë e njeriut bëhet e dukshme përmes veprave dhe sjelljeve të tija. Çdo njeri kupton se cili njeri e do atë singërisht dhe cili jo. Dhe, në bazë të kësaj mund të themi se shumica e muslimanëve nuk e duan Ehli Bejtin. Kjo për arsye se e dimë se sa po i japin vend fesë në jetën e tyre. Mund të themi lirësisht se shumica e muslimanëve nuk e respektojnë dhe nuk janë zemërçelur ndaj Ehli Bejtit.

Jeta dhe vepra e Dalip Frashërit



Dalip Frashëri (Frashër, shekulli XIX). Poet i shquar. Ka shkruar “Hadikanë” me 732 faqe dhe që i kalon 65.000 vargjet. Autor i origjinalit është persiani Husejn Vaizi. Dalip Frashëri e përktheu në prozë e poezi nga turqishtja e përshtatur nga shkrimtari turk Fuzuliu. Titulli i veprës është “Hadikatus-Suada” që do të thotë “Pemishtja e të mirëve”.

Ne e njohim këtë vepër të përkthyer nga Dalip Frashëri me emrin e shkurtuar “Hadika”, ashtu siç e njohu më vonë edhe populli. Dalip Frashëri, i cili u ndodh në vështirësi të shkrimit me alfabet arab, që nuk i përgjigjej fonemave shqipe, gjatë kompozimit të veprës së atij ankohej duke thënë:

✱Gjer që shqipja është zahmet
edhe nuk e këndonetë,
se harfet janë gallet
nuk e qëronetë...✱

Dalip Frashëri na thotë se e shkroi këtë vepër më 1842. Përmbajtja e “Hadikasë” ka për subjekt kryesisht tragjedinë e Qerbelasë. Kjo këndohet veçanërisht në periudhën e matemit (zisë), që i përgjigjet dhjetëditësisht të parë të muajit hënor të Muharremit, që për bektashinjtë është periudha e agjërimit. Sipas “Historisë së Letërsisë Shqipe”,

vepra s’ka vlera artistike, por ka rëndësi vetëm historiko-gjuhësore.

Mahmud Hysa në një punim të tij thekson: “... Vepër më voluminoze e mbarë letërsisë sonë, “Hadikaja” e Dalip Frashërit, me mbi 60.000 vargje, është lënë jashtë interesimeve më elementare me motivacionin se s’ka tematikë kombëtare. Besoj se kjo vepër meriton studime më serioze në mos për gjë tjetër, atëherë së paku se ajo ka qenë “abetare” poetike e Naim Frashërit”.



Kurse historian Kristo Frashëri thotë:

“Naimi e ka njohur “Hadikanë” që kur jetonte në vendlindje, aq më tepër që ajo vlerësohej si libri i bektashinjve të asaj kohe. Megjithatë, sado

që e çmoi poemën e Hyxhretiut, Naimi u bë edhe kritiku i saj... sepse e kishte mbushur poemën me fjalë turqishte...”.

Huazur nga libri: “Panteoni iranien dhe iranologët shqiptarë”, autor: Shefik Osmani, botues: Fondacioni Kulturor “Saadi Shirazi”, Tiranë 1998, fq. 43-44.

Allame Muhamed Ikbali

për rolin e femrës

"Në Islam femra është e gjallë, konstruktive dhe e adaptueshme, por ajo duhet të kuptojë se gjëja më e vlefshme për të është maturia".

Pastaj vazhton e thotë:

"Njeriu i cili është lindur jashtë mitrës së gruas, e shkelë krenarinë e saj dhe gjithmonë e mban në stagnim".



Muhamed Ikbali është njëri ndër filozofët më të mëdhenj të Islamit, reformator i madh musliman i lindur në vitin 1877 në Sialot të Penx habit. Koha e lindjes së tij karakterizohet me dekadencë morale e ekonomike, diskriminim racor, pabarazi sociale dhe injorancë. Të gjitha këto karakteristika gjendeshin më tepër te femrat muslimane. Pra, në ato kushte e rrethana kultura islame ka prodhuar personalitetin më të madh që konsiderohet fenomen i rrallë në një ambient të tillë.

Ikbali i takon rangut të rëndësishëm njerëzor që ia kanë kushtuar tërë jetën Islamit, zgjimit të muslimanëve dhe çlirimit nga kolonializmi e eksploatimi. Vlera dhe madhëria e tij mbështeten në atë se ai ka funksionuar në kohën kur kultura e pasur islame konfrontohej në të gjitha anët dhe ishte strofulluar në vetvete.

Gjithë historianët dhe mendimtarët që kanë diskutuar rreth lëvizjeve politike e revolucionare gjatë dyqind viteve të fundit, kanë qenë të obliguar të diskutojnë edhe për këtë personalitet si një figurë më markante në zgjimin e muslimanëve. Ai u bënte ftesë muslimanëve që të frymëzohen prej oqeanit të pasur islam dhe ta shuajnë etjen me dituri:

"O robër të tokës! O ju që plotësoni kohën në tokë.

Pini prej verës së besnikërisë dhe zgjohuni nga gjumi i thellë".

Ai iniconte zgjimin në vendet e fjetura orientale dhe ishte pionier i lëvizjeve për nder e liri të muslimanëve, posaçërisht të atyre të subkontinentin indian. Jo vetëm me fjalët e tij por edhe me veprën e tij ai ishte shembull për muslimanët që ishin nënshtruar para kolonializmit:

"Çfarë dobie kemi nëse hamë e pijmë si kafshë?

Nëse nuk mund të mbështetemi as në veten tonë, apo çfarë dobie kemi prej ekzistencës tonë?"

Ikbali ishte yll që ndriçonte në horizontet e kontinentet dhe rrëmujë për muslimanët që kishin qëndrim liberal ndaj Perëndimit në atë hapësirë. Zjarri i tij ka mundur t'i ndezë zemrat e muslimanëve kurse efekti ishte në dukje e sipër:

**“Deri kur do të jenë rrobat tuaja të grisura?
Deri kur do të jetë vendbanimi juaj nën tokë
si ai i buburrecave?”**

**Fluturoni si shqiponja, deri kur do të lypni
ushqimin tuaj në barroja?”**

Ikbali ishte mistik i singertë, dijetar, filozof, intelektual, poet liberal, filantropist, gjegjësisht realist dhe politikan futurist, nën ndikimin e të cilit paraqitet populli islam në skenën botërore. Ai u bënte apel gjithë njerëzve të praktikojnë barabarësinë dhe atë me një zë që do të jehojë përgjithmonë: “Ne nuk jemi në lidhje me arabët ose romakët, ne nuk lidhemi me ndonjë ekzistencë të vetmuar, ne dashurojmë atë që është në Hixhaz dhe për këtë jemi të lidhur në mes vete”. Pa kurrfarë kompleksi ai kërkonte realitetin, kurse idetë dhe filozofinë e vet i merrte nga Kurani dhe Islami:

“Ti e di se cili është besimi yt, fshehtësia e ekzistimit tënd në këtë botë;

Ky libër i gjallë, Kurani Famëllartë, i cili ka urtësi të paarritur e të brendshme;

**Ai (Kurani) zbulon sekretin e ekzistencës,
dhe të gjitha gjërat e shtrembëruara drejtohen me të”.**

Ai parashtroi idenë se intelektualët e singertë duhet të pasurohen me Kuran dhe Islam sepse në të kundërtën, identiteti i tyre do të zhduket. Ikbali orvatej ta realizojë idenë dhe planin për udhëheqjen e popullit dhe tokës. Me fjalët e veta ai i dërgonte mesazhe Orientit dhe e inspironte me ide të reja. Mesazhet e tij më të pasura i shprehte nëpërmjet poezisë dhe prozës së dedikuar femrave edhe atë me një respekt jashtëzakonisht të madh.

Shumë poetë, shkrimtarë e letrarë e kanë vlerësuar gruan ashtu që fjalët e tyre asnjëherë nuk do të harrohen. Femra ka luajtur rol shumë të rëndësishëm në historinë e njerëzimit. Mendimet e Ikbali për gruan janë aq të thella sa që kanë nevojë të studiohen me kujdes të madh nëse dëshirohet të kuptohen; në realitet, ai i përdorte të njëjtat terme e ekspresivitate që theksohen në Kuran. Në Kuran gratë prezentohen si qenie brilante, të drejtat e tyre qartësisht ceken e potencohen, mirëpo nuk duhet të harrohet se si femra ashtu edhe mashkulli kanë identitet me karakter individual. Femra në Kuran paraqet personifikim të natyrës dhe për këtë ka koekzistencë mes etikës së Kuranit dhe natyrës. Islami që prej fillimi i caktoi të drejtat e gruas të humbura fare. Muhamedi (pqmtf) thotë: “Gratë janë amanet hyjnor mes nesh dhe për këtë respekti ato!”

Në Kuran femrat janë simbol i dashurisë kurse barabartësia potencohet në shumë aspekte. “O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njoheni ndërmjet vete, e s’ka dyshim se tek Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (nga të këqijat) e Allahu është shumë i dijsëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë” (Surja el-Huxhurat, ajeti 13).

Ikbali në një anë vështronte manifestimin e injorancës lindore kurse në anën tjetër eksperiencën dhe presionin e civilizimit perëndimor. Ai thotë: “Liria evropiane nuk përmban në vete shpirtin e vërtetë të gruas. Gruaja e ndershme e mbron veten nga shoqëria e korruptuar dhe konfirmon se detyra më e ndershme dhe më e vlefshme e saj është ‘të jetë grua’.

Problemi që e preokuponte shumë Ikbali ishte ai i Lindjes dhe i Perëndimit. Ai ka zgjedhur rrugën, ashtu që njeriu lindor të mos eliminohet nga ai perëndimor dhe të jetojë në kulturën e tij të pavarur (as Lindje as Perëndim). Muhamed Ikbali shpeshherë shprehte mendimin e tij ndaj pozitës së gruas në shoqërinë perëndimore nëpërmes vargjeve dhe konfirmonte se mashkulli është përgjegjës për korrupsionin si dhe theksonte se ligjet natyrore nuk mund të zëvendësohen me gjendjen momentale të civilizimit, gjë që nënkupton se janë të ndryshueshëm dhe se janë argument të pabaza.

Duke e shfrytëzuar me një shkathtësi kulturën islame, ai prezenteonte ide të reja që ishin të inspiruara vetëm nga ideologjia islame. Qëndrimin e Islamit të vërtetë ndaj gruas është krejtësisht ndryshe nga ai i shoqërisë bashkëkohore perëndimore. Ky qëndrim është i shëndoshë dhe mund të gjendet vetëm në shoqërinë e shëndoshë.

Ikbali ishte mendimtar musliman, reformator dhe lider i antikolonializmit. Ai e ndjente veten si përgjegjës për kohën dhe shoqërinë e tij në atë kohë kritike. Ai i frikësohej faktit që vlerat fetare (religjioze) të injorohen, kurse ajo që dominonte në shoqëri ishte pozita e gruas. Kur zhvillohej çështja e lirisë seksuale, ajo pritet me mirëseardhje dhe mu për këtë shkak faktori më kryesor i luftës mes njerëzve qëndron në kolapsin e vlerave etike dhe familjare. Ikbali thotë: “Në Islam femra është e gjallë, konstruktive dhe e adaptueshme, por ajo duhet të kuptojë se gjëja më e vlefshme për të është maturia”. Pastaj vazhton e thotë: **“Njeriu i cili është lindur jashtë mitrës së gruas, e shkelë krenarinë e saj dhe gjithmonë e mban në stagnim”.**

Sipas Ikballit, femra është baza e shoqërisë dhe respektimin e saj e ka porositur shumë herë edhe vet Muhammedi s.a.a. Prestigji, fuqia, nderi, shëndeti dhe pavarësia e çdo shoqërie varen nga lidhja me fëmijët e shëndoshë familjarë që janë lindur e që janë zhvilluar me ndihmën e nënës.

Ikballi e respektonte shumë nënën e vet. Me siguri, roli më i rëndësishëm i gruas është ai i nënës. Ky rol është përqendruar që prej kohës së krijimit dhe përputhet me kapacitetin e saj psikik e intelektual. Nuk është e thjeshtë e as e kuptueshme dashuria e nënës në çfarëdo kohë e çfarëdo vend. Vetëm zemrat e nënave janë pakufi të gjera kur është fjala për dashurinë e tyre ndaj fëmijëve.

Ikballi dëshironte t'i ngjallë të drejtat e nënës së nënkontinentit. Sipas tij, gruaja muslimane është mbrojtëse e shoqërisë, roje e prestigjit familjar; ajo mbron rrethin familjar me ndjenjat e saja të ngrohta dhe kontribuon në zhvillimin e vendit me

rritjen e fëmijëve të shëndoshë e të edukuar.

Ikballi ua rekomandonte të gjitha femrave Fatimen, vajzën e Muhammedit (paqja qoftë mbi të dhe familjen e tij) si shembull për to. Në realitet, asnjë pozitë në Islam nuk krahasohet me pozitën e saj. Ajo ishte trashëgimtare e Muhammedit a.s. dhe për këtë gëzon respekt të lartë. Ikballi për të thotë:

“Merjemja respektohet për shkak të lidhjes së saj me Isaun, kurse Fatimja për shumë shkaqe, sepse ajo është bebbëza në syrin e mëshirës së tokës, prijësit të parë e të fundit, të vetmit që ka flijuar jetën për njerëzinë, të vetmit që predikonte fe të re, grua e luanit të zgjedhur e të devotshëm...”

Ikballi më tepër përqendrohej në arsimimin e femrave se sa të meshkujve edhe atë duke thënë:



“Roli i gruas në ndërtimin e shoqërisë është më i madh se ai i meshkujve. Gruaja islame e mbron pastërtinë dhe është krijuese e meshkujve”.

Ai i kritikon femrat përëndimore për shkak se ato e refuzojnë rolin e nënës. Në “Zarb Kalim” thotë: “Edukata evropiane sjell vdekjen e amësisë dhe e shkatërron. Kjo, në anën tjetër gruan e shndërron në ‘jogrua’ dhe emërtohet si ‘vdekje e vetëdijshme’. Nëse shkolla e femrave u mbetet e huaj instruk-

sioneve fetare, atëherë shkenca dhe arti do të kuptojnë se e kanë arritur vdekjen e dashurisë”.

Shkrim i huazuar nga revista kulturore islame “Nur”, nr. 3, Shkup 1994, fq. 43-45.

Kuptimi i Haxhit

“Të vizituarit e tempullit, për hir të Allahut,
për atë që ka mundësi” (Surja Ali ‘Imran, ajeti 97).

“Dhe shpallua njerëzve Haxhin! Do të vijnë në këmbë dhe me deve të rraskapitura; do të vijnë nga largësi të thella” (Surja el-Haxh, ajeti 27).

Imam Aliu (a.s.) ka thënë: “Kini frikë, dhe sërish kini frikë Zotin në lidhje me Shtëpinë e Zotit tuaj! Mos e braktisni derisa jeni gjallë, sepse nëse ajo braktiset, as ju nuk do të jeni ata të cilët duhet marrë si shembull” (Nehxhul-belaga, letra 47).

Imam Aliu (a.s.) në lidhje me Haxhin ka thënë: “Haxhi është xhihad i çdo të dobëti” (El-Hisal, 62/10).

“Një dërrhem i shpenzuar në rrugën e Haxhit vlen sa njëmijë dërrhem” (El-Hisal, 628/10).

“Haxhiu në Haxh dhe Umre është mysafir i Zotit dhe Ai e fal” (El-Hisal, 635/10).

Kuptimi i Haxhit

Imam Aliu (a.s.) në lidhje me kuptimin e Haxhit ka thënë: “Allahu ua bëri të obligueshëm vizitën në Shtëpinë e Tij të shenjtë e cila është pikë orientimi për njerëzit të cilët kthehen drejt saj, ashtu si bagëtia që kthehet në vendbanimet e tyre dhe kërkon strehim në të dhe sikur pëllumbat që kërkojnë strehim. Allahu Famëllartë e ka bërë simbol të përlësisë dhe pendimit ndaj Famës së Vet dhe simbol i përlësisë ndaj Fuqisë së Vet” (Nehxhul-belaga, fjalimi 1).

Imam Zejnel-Abidini (a.s.) ka thënë: “Kryeni Haxhin dhe Umren, trupat do t’ju mbesin të shëndoshë, furnizimi do t’ju shtohet, imani do t’ju mbetet i qëndueshëm dhe do t’u sigurohen gjërat e domosdoshme njerëzve dhe familjeve tuaja” (Sev-abul-a’mal, 70/3).

Imam Muhamed Bakir (a.s.) ka thënë: “Haxhi vepron qetësisht në zemra” (Emali et-Tusi, 296/582). Imam Xha’fer Sadiku (a.s.) rreth kuptimit të Haxhit ka thënë: “Kjo është Shtëpia nëpërmjet së cilët Allahu krijesat e Tij i nxiti në përlulje, që t’i provojë përlulësinë e tyre përmes presences në të. I nxiti në lavdërimin dhe zjaretin (vizitën) e saj. Jua bëri vendin e të Dërguarit dhe Kible (drejtim-orientim) për ata që falen. Ajo është një degë e kënaqësisë së

Tij, rruga me të cilën arrihet adhurimi ndaj Tij. Ajo është e vendosur në përsosmërinë qëndruese dhe në qendër të lartësimit” (Emali es-Saduk, 493/4; Et-Tevhid, 253/4).

“Nuk ka pjesë më të dashur të tokës së Allahut Famëllartë se vendi i bërjes së sa’jit (ecjes mes kodrave Safa dhe Merva), sepse këtu është i përlulur çdo tiran dhe dhunues” (El-Bihar, 99/45/34). Imam Ali Rida (a.s.) për kuptimin e Haxhit tha: “Nëse thuhet: ‘Pse është përcaktuar haxhi?’ Në përgjigje duhet të thuhet: ‘Për shkak të shkuarjes tek Allahu i Lartësuar dhe të kërkuarit lartësim ndaj Tij, krahas njohjes së diturisë fetare dhe transmetimeve të fjalëve të imamëve (a.s.), në të gjitha anët dhe viset’” (‘Ujun akhbarur-Rida, 2/119/1).

Haxhi mënjanon varfërinë


I Dërguari i Allahut (s.a.a.) tha: “Haxhi mënjanon varfërinë” (Tuheful-‘ukul, 7).

Imam Xha’fer Sadiku (a.s.) në lidhje me mënjanimin e varfërisë së atyre që e kryejnë Haxhin ka thënë: **“Kush e kryen Haxhin tri herë, asnjëherë nuk do ta godasë varfëria”** (El-Hisal, 117/101).

“Nuk kam parë asgjë që aq shpejt e sjell pasurinë dhe e mënjanon varfërinë sikur që është këmbëngulja në zjaretin (vizitën) e kësaj Shtëpie” (Emali et-Tusi, 694/1478).

Is’hak ibn Ammari duke iu drejtuar Imam Xha’fer Sadikut (a.s.) i tha: **“Kam vendosur që për çdo vit, patjetër, të shkojë në Haxh ose ta dërgojë dikë nga familja ime me paratë e mia”**. Imami e pyeti: **“Ke vendosur bindshëm një gjë të tillë?”** Is’haku u përgjigj: “Po”. Imami tha: **“Nëse e bën këtë, të jesh i sigurt në shtimin e pasurisë. Të njoftoj me lajmin e gëzuar se pasuria jote ka për t’u shtuar”** (Sev-abul-a’mal, 70/4).

Huazuar nga libri: “Peshorja e urtësisë (përmbledhje e haditheve)”, autor: Muhamedi Rej Shehri, përkthyes: Besa Bytyqi, Prizren 2010, fq. 135-137.



Ditëlindja e Imam Ali El-Hadi a.s.

Lindja, fëmijëria dhe shkollimi

Imam Ali El-Hadi lindi në qytetin e Medinës më 8 shtator 829 ose në mes të muajit Dhul-Hixheh të vitit 212 të Hixhretit (Emigrimit) të Profetit Muhamed (paqja qoftë mbi të dhe familjen e tij) nga Meka në Medine. Babai i tij ishte Imam Muhamed el-Xhevad dhe nëna Hazreti Sumana. Si i vogël mori mësim te babai i tij i cili ishte imami i nëntë i Ehli Bejtit dhe trashëgues i diturive, mbartës i njohurive të shpalljes, udhërrëfyes për urtësi dhe orientim.

Personaliteti

Imam Ali El-Hadi është një prej imamëve udhërrëfyes të Ehli Bejtit, maja e dijetarëve, besimtarëve, reformatorëve, ylli ndriçues i jetës së umetit në të gjitha fushat e tij, prandaj ai ishte burim i frikës dhe i zemërimit për udhëheqësit sundues. Ai ishte shembull në moral, besim, thjeshtësi, në kundërshtim të padrejtësisë dhe të padrejtëve, fener ndriçues i diturive dhe i veprave. Vërtet dijetarët dhe personalitetet politike dhe historianët e cilësuan me ato që ai i meriton. Për të tregohet shumë ngjarje besimshtytëse. Dy nga këto ngjarje i transmeton Sibt ibn Xhevizij:

• Ai tha: “Shkova në Medinë dhe kur hyra te shtëpia e tij, u dëgjua një zhurmë e madhe prej njerëzve që erdhën për ta frikësuar Imamin sepse ai ishte bamirës për ata, gjithmonë shkonte në xhami, nuk ishte i anuar nga kjo botë. Kur fillova të kontrolloj shtëpinë e tij, nuk gjeta tjetër gjë përveç Kuranit, librave të lutjes dhe librave të njohurive”.

• Ndërsa për ngjarjen në qytetin Samarra thotë: “Në këtë qytet e sulmuan shtëpinë e Imam El-Hadit dhe e kontrolluan. Ata që e sulmuan shtëpinë e tij, nuk gjetën asgjë në të. Imamin e gjetën në një dhomë të mbyllur i cili kishte veshur një xhybe prej leshi, i ulur mbi gurë dhe rërë, i drejtuar tek Zoti i Madhëruar duke lexuar ajete të Kuranit”.

Konfliktet politike në kohën e Imamit

Jeta e Imam Ali El-Hadit ishte e mbushur me fatkeqësi dhe ashpërsi. Ai e mori udhëheqësinë e Imamatis që në moshë të re dhe jetoi në kohën e sundimit të gjashtë kalifëve abasitë si: Mu'tesimit, El-Vathikut, El-Mutevekkilit, El-Muntəsirit, el-Muste'init dhe El-Mu'tezit. Kjo periudhë kohe ishte e mbushur me ndodhira dhe konflikt politik të ashpër në mes ithtarëve të Ehli Bejtit dhe abasitëve. Imami praktikonte rolin e edukuesit, orientuesit, përgatitësit për të ballafaquar sunduesin e padrejtë, si dhe përhapjen e botëkuptimit të saktë islam. Si pasojë e frikës së sunduesve abasitë prej Imam Ali El-Hadit, ata e vendosën



Imami El Hadi është shembull në moral, besim, thjeshtësi, në kundërshtim të padrejtësisë dhe të padrejtëve, fener ndriçues i diturive dhe i veprave.



nën kontroll atë dhe i vënë ndjekës, të cilët mbledhnin të dhëna rreth lëvizjeve të tij, me qëllim që të mundësojnë ta largojnë atë dhe ndikimet e tij intelektuale dhe politike nga njerëzit. Ithtarët e Ehli Bejtit më së shumti pësuan gjatë kohës së sundimit të kalifit abasit El-Mutevekkil.

Fillimi i kryengritjeve

Kur pozita e Imam Ali El-Hadit në Medinë u bë e rrezikshme për pushtetin e kalifit el-Mutevekkil, u shtuan përpjekjet për akuzimin e Imamit, dhe kundërshtarët e tij u përpoqën të bindnin kalifin se Imami po përgatitet për revolucion dhe se ai po grumbullon para, armë dhe ushtri. Kalifi dha urdhër që Imami të nxirret nga Medina dhe të çohet në Samarra me qëllim që të jetë nën kontroll dhe ndjekje. Edhe në Samarra nuk e lanë të qetë, vazhdimisht e sulmonin dhe e kontrollonin shtëpinë e tij. Meqë nuk gjenin asnjë dëshmi kryengritjeje në shtëpinë e tij, planet shkuan më tej, u mendua që Imamin ta vrisnin sepse nuk gjenin rrugën për ta fshehur personalitetin e tij dhe ta izolonin rolin dhe ndikimin e tij.

Pas kalifit El-Mutevekkil vjen në pushtet El-Muntasari, i cili ishte më i butë me ithtarët e Ehli Bejtit, ky i hoqi presionet dhe terrorizmin prej tyre, ua ktheu pasuritë, i lejoi njerëzit të vinin për vizitë në mauzoleun e Imam Husejnit dhe Imam Aliut, i liroi të burosurit etj. Pas tij erdhi në pushtet kalifi Mu'tesim, ky ishte i rreptë me ithtarët e Ehli Bejtit, po këta iu kundërvuan me revolucion në qytetin e Kufes. Koha më e keqe ka qenë koha e sundimit të El-Mu'tezit. Moraliteti i pushtetit abasit mbërriti në gjendjen më të ulët në këtë periudhë. Krimet, ashpërsitë, injoranca dhe prapambeturia sundonte te shumica e njerëzve. Si pasojë e kësaj gjendjeje misioni i Imam Ali El-Hadit ishte mbrojtja e shpalljes dhe edukimi i një brezi dijetarësh dhe thirrësish në Islam, sepse ana e diturisë dhe kultura përbënin bazën kryesore të ndërtimit të shoqërisë islame dhe shtetit islam të përparuar.

Vdekja e Imam Rizait

Sipas Shejh Tusiut, Imami para se të vdiste kishte 185 nxënës dhe transmetues të haditheve të cilët studiuan dhe transmetuan nga ai. Jeta e tij ishte e mbushur me përpjekje, me dituri, me punë, me thirrje në Librin e Allahut dhe Praktikën e Profetit (pqmtf). Ai jetoi në vijën e Sheriatit dhe u ballafaqua me përndjekjet, terrorin, presionet e sunduesve të kohës që jetoi. Ai vdiq më 01 korrik 868 ose 3 rexheb 254 sipas Hixhretit në moshën 38-vjeçare

*O Allah! Bekoje Muhamedin dhe Familjen e Muhamedit (pqmtf)!
Paqja goftë mbi ty o Imam Ali El-Hadi (pqmtf)!*

Hashimitët para lindjes së Islamit

Në shekullin e pestë pas Krishtit, një njeri i quajtur Kusaj lindi në fisin e Kurejshit. Ai i solli famë dhe respekt fisit të tij me urtësinë që kishte. E rindërtoi Qaben, e cila ishte në gjendje të mjerueshme dhe u urdhëroi arabëve t'i ndërtonin shtëpitë e tyre përreth saj. Ai ishte i pari që e ndërtoi “ndërtesën bashkiake” të Mekkes, një risi kjo për Arabinë. Në këtë ndërtesë fise të ndryshme mbledheshin për të diskutuar në lidhje me problemet e tyre sociale, ekonomike, kulturore dhe politike. Kusaji formuloi ligje për furnizimin me ushqim dhe me ujë të pelegrinëve që vinin në Mekke dhe, gjithashtu, i bindi arabët që të paguanin një tatim për ta financuar këtë veprimtari.

Edward Gibbon:

Kusaji, i lindur rreth vitit 400 pas Krishtit, stërgjyshi i Abd'ul-Muttalibit dhe rrjedhimisht brezi i pestë para Muhammedit, fitoi një fuqi supreme në Mekke... (“Rënia dhe shkatërrimi i Perandorisë Romake”).

Kusaji vdiq në vitin 480 pas Krishtit dhe i biri Abd'ul-Menafi e zëvendësoi atë. Edhe ai u dallua për aftësitë e tija, për bujarinë dhe për gjykimin e tij të mençur. Pasardhës i tij ishte Hashimi, prej të cilit rrjedh edhe emri i këtij fisi që në histori do të njihet si “Benu Hashim” (në përkthim: “bijtë e Hashimit” ose thjesht “hashimitët”).

Hashimi ishte një njeri i veçantë. Ai e bëri Kurejshin një fis tregtar dhe më të rëndësishmin nga fiset arabe. Është pikërisht Hashimi, personi i cili i themeloi i pari dy karvanët tregtarë, veror e dimëror, të Kurejshit dhe i pari që ua prezantoi arabëve gjellën e tyre të famshme të quajtur “tharid”. Po të mos ishte ky person, arabët do të mbeleshin përgjithmonë blegtorë.

Udhëheqësia bujare dhe vizionare ishin vetëm dy nga cilësitë, të cilat Muhammedi i trashëgoi nga stërgjyshërit e tij. Hashimi u martua me një grua nga Jethribi dhe prej saj pati një djalë: Abd'ul-Muttalibin. Pas një kohe, Abd'ul-Muttalibi e zëvendësoi të atin në pozitën e tij si prijës të Hashimitëve.



Edward Gibbon:



Gjyshi i Muhammed-it (Abd'ul-Muttalibi) dhe paraardhësit e tij, brenda dhe jashtë Mekkes e kishin imazhin e princërve të krahinës së tyre por sunduan si Perikliu në Athinë ose si familja Medici në Florencë, të cilët sundonin me anë të mendimit

dhe urtësisë së tyre. Ndikimi i tyre bashkohej me pasurinë që kishin.

Fisi i Kurejshit, me dhunë ose jo, e kishte fituar kujdestarinë e Qabes. Këtë pozitë e trashëgoi gjyshi i Muhammedit dhe për këtë arsye familja e Hashimitëve ishte më e respektuara dhe më e shenjta në sytë e njerëzve. Prejardhja e Muhammedit nga Ismaili ishte një krenari për të dhe ndonëse gjeneratat e para të pemës gjenealogjike ishin disi të errëta, ai prapëseprapë mund të vërtetonte një origjine fisnike të familjes së tij prej gjeneratash. Ai ishte nga fisi Kurejsh dhe nga familja e Hashimitëve, më e famshmja ndër arabët, princërit e Mekkes dhe kujdestarët trashëgimtarë të Qabes (“Rënia dhe shkatërrimi i Perandorisë Romake”).

Hashimi kishte një vëlla më të vogël që quhej Muttalib. Pas vdekjes së Hashimit, ai ishte prijës i fisit për një kohë të caktuar por me vdekjen e tij, nipi i tij dhe i biri i Hashimit, Abd'ul-Muttalibi e trashëgoi si prijësi i ri. Bashkë me këtë post i trashëgoi edhe cilësitë fisnike të cilat i kishin sjellë lavdi babait dhe gjyshit të tij.

Siç u përmend edhe më sipër, qyteti i Mekkes, njësoj si e gjithë Arabia, ishte pa ndonjë formë qeverisjeje dhe pa sundues. Prapëseprapë ajo

dominohej nga fisi i Kurejshit.

Kurejshi përbehej nga dymbëdhjetë familje dhe Hashimitët ishin njëra prej tyre. Si një reagim kundër imoralitetit që e kishte kapluar shoqërinë, familja e Hashimitëve, gjysmë shekulli para lindjes së Muhammedit bëri disa përpjekje për ta ndaluar këtë degradim moral të arabëve dhe për ta përmirësuar gjendjen e tyre sociale, ekonomike dhe intelektuale. Me këtë qëllim, ata e themeluan atë që do të quhej “Lidhja e të virtutshmëve”. Qëllimet kryesore të kësaj lidhjeje ishin pengimi i luftërave ndërfisnore dhe mbrojtja e personave të dobët dhe të pastrehë nga armiqtë e tyre.

Hashimitët ishin gjithashtu të interesuar në përpërimin ekonomik të arabëve dhe për këtë qëllim ata u bënë nismëtarë të tregtisë me vendet fqinje, duke dërguar verës karvanë për në Siri dhe dimrit për në Jemen. Këto karvanë niseshin nga Mekkeja me hurma, shala dhe yzengji për kuaj e për deve, batanije nga leshi e nga qimet e devesë, parfume, erëza, mëlmesa, temjan, lëkurë devesh dhe kuaj të racës.

Në kthim ata sillnin copa për veshmbathje, vaj ulliri, armatime, kafe, fruta dhe drithëra. Njësoj si “Lidhja e të virtutshmëve”, edhe karvanët tregtarë ishin dhurata të pakontestueshme të Hashimitëve për arabët. Por dhurata më e madhe që ata do t’ua bënin jo vetëm arabëve por të gjithë botës, do të ishte fëmija i quajtur Muhammed, djali i Abdul-lahut të Abd’ul-Muttalibit dhe Amines, bijës së Vahabit.

Ai do të ishte njeriu më i dobishëm jo vetëm për arabët por për të gjithë njerëzimin. Njëra nga ngjarjet që ndodhën gjatë periudhës së Abd’ul-Muttalibit si kujdestar i Qabes, ishte pushtimi i Mekkes nga një ushtri abisiniane, e udhëhequr nga gjenerali i krishterë, Abraha. Përpjekja për ta pushtuar Mekken dështoi, siç përcillet edhe në vargjet e Kur’anit:

...dhe Ai dërgoi kundër tyre zogj fluturues, që i goditën me gurë e me baltë të thatë. Pastaj i bëri si një gjeth i brejtur...

(Kur’an 105:3-5).

Për arsyen se pushtuesit kishin marrë me vete edhe elefantë, viti i kësaj ngjarjeje u mbajt mend si “Viti i Elefantit”. Viti i Elefantit është viti 570 i erës sonë, që është pikërisht viti në të cilin lindi Muhammedi, profeti i ardhshëm i Islamit. Ushtria sulmuese u tërhoq nga Mekkeja dhe nenet e mar-

rëveshjes dypalëshe u vendosën në negociatat që i udhëhoqi Abd’ul-Muttalibi.



Sir John Glubb

Në vitin 570, Abraha, guvernatori i krishterë, abisin i Jemenit, marshoi drejt Mekkes. Fisi Kurejsh ishte tepër i dobët dhe pa vetëbesimin e nevojshëm për t’u përballur me ushtrinë abisiniane. Abd’ul-Muttalibi, si prijës i grupit, doli për të bërë negociata me Abraha-n

(“Pushtimet e mëdha arabe”, botuar 1963).

Njëri nga kushërinjtë e largët të Hashimit ishte Abd’ush-Shemsi. Njëfarë Umejje, i cili pretendonte se ishte djali i këtij të fundit, ushqente në vete një xhelozi ndaj origjinës dhe prestigjit të Abd’ul-Muttalibit. Njëherë, madje, u përpoq t’ia merrte këtë pozitë nga duart dhe dështoi.

Ky dështim i mbeti përgjithmonë në zemër. Ai vazhdoi të ushqente një urrejtje ndaj Abd’ul-Muttalibit dhe fëmijëve të tij dhe të njëjtën ua përcolli djemve të vet dhe nipërve, të cilët u bënë të njohur në histori si “Beni Umejje” (“bijtë e Umejjes” ose siç njihen më mirë “Umajjadët”).

Por në urrejtjen e Umajjadëve kishte diçka më tepër se xhelozi fisnore ndaj Hashimitëve. Të dyja këto familje ishin antagoniste të njëra-tjetrës përnga karakteri, sjellja, pamja dhe mënyra se si e kuptonin jetën. Kjo do të shihej nga ngjarjet që do të vijonin, ku Umajjadët do të ishin flamurtarët e armiqtësisë ndaj Islamit.

Hashimitët, në anën tjetër, ishin destinuar për të qenë kështjella dhe mburoja e Islamit. Ishte vetë Zoti që i zgjodhi për këtë detyrë të lavdishme. Sociologu dhe historiani i famshëm mysliman, Ibn Khaldun-i, në pjesën “Mukaddime” (Hyrje) të veprës së tij, shkruan se të gjithë profetët e famshëm e kanë gëzuar përkrahjen e një grupi të fuqishëm. Përkrahja e tyre, sipas tij, është e nevojshme sepse i shërben profetit si një mburojë kundër armiqve dhe i jep atij një siguri, pa të cilën nuk mund ta përmbushë misionin e tij hyjnor.

Në rastin e profetit Muhammed, ishte pikërisht familja e Hashimitëve ajo që e përfaqësonte “grupin e fuqishëm” që do ta mbronte nga urrejtja dhe mizoria e Umajjadëve dhe që do t’ia mundësonte vazhdimin e misionit të tij hyjnor.

Abd’ul-Muttalibi kishte dhjetë djem. Katër prej tyre u bënë të famshëm në histori:

- Abdullahu, babai i Muhammedit
- Ebu Talibi, babai i Aliut
- Hamza, heroi-martir i betejës së Uhudit
- Abbasi, pasardhësit e të cilit e themeluan dinastinë Abbaside

Abdullahu dhe Ebu Talibi ishin nga e njëjta nënë, kurse djemtë e tjerë të tij lindën nga gra të tjera.

Marrë nga libri “Ritregim i historisë së Islamit dhe myslimanëve”, autor: Sejfid Ali Asghar Razvi, përktheu: Numan Mustafa, shtëpia botuese: “Dielli”, Prishtinë, qershor 2013, fq. 56–59.



Tregime nga Mesnevi-ja

Arkitekt Sinani, minarja e shtrembër dhe fëmija

Arkitekt Sinani duke kaluar pranë fëmijëve që po luanin përballë xhamisë Sulejmanije dëgjoi një fëmijë duke i thënë shokut të tij: “Kjo minare qenka e shtrembër”. Arkitekt Sinani sapo dëgjoi menjëherë i tha: “Më trego mua, ta shohim cila minare qenka bërë shtrembër”. Fëmija i vogël e drejtoi gishtin kah minarja në anën e djathtë. Arkitekt Sinani i urdhëroi mjeshtërit që të sillnin një litar. Punëtorët pasi sollën litarin e lidhën atë me majën e minares. Arkitekt Sinani e thirri pranë fëmijën duke i thënë: “Tani punëtorët po e drejtojnë minaren, kur të drejtohet minarja ti na trego dhe na bë me shenjë”. Punëtorët kishin filluar ta tërhiqnin litarin dhe pas pak fëmija kishte thënë: “Në rregull, (minarja) u drejtua”. Arkitekt Sinani duke iu kthyer i tha fëmijës: “Tani, u drejtua?” Fëmija u përgjigj: “Po u rregullua. Tani duket më bukur”.

Mjeshtërit duke mos e kuptuar situatën, e kishin pyetur: “Arkitekti ynë i madh, ti e di më mirë se



të gjithë që minarja nuk ishte e shtrembër, përse u mundove që ta drejtosh?” Arkitekt Sinani duke iu kthyer mjeshtërve, iu kishte thënë: “Nëse nuk e kishim drejtuar minaren e shtrembër në kokën e fëmijës, sa herë që do të kishte kaluar pranë xhamisë, fëmija nuk kishte për ta parë kurrë bukurinë e saj të vërtetë. Nëse nuk merren masat,

edhe nëse nuk bëhen thashetheme mbeten gjurmët, kështu që edhe emri i xhamisë do të ishte përhapur si xhamia minareshtrembër”.

Budisti dhe prifti

Në një ditë me shi, një budist dhe një prift po shkonin së bashku diku. Rrugës e hasin një grua të alivanosur, të shtrirë në rrugë. Budisti kishte vazhduar të ecte duke mos e shikuar, sepse sipas tyre ishte e ndaluar të prekësh një femër dhe ky ishte i bindur në rregullat (e fesë). Prifti u afrua, e mori në duar dhe e dërgoi në anën tjetër. Pastaj, të dy kishin vazhduar rrugën. Budisti ende mendonte se si mund ta bënte prifti këtë, se si i shkeli ai rregullat. Pas pak kohe, nuk kishte duruar dhe i kishte thënë: “Duke e dikur që është e ndaluar, si e preke gruan dhe e mbajte në duar atë?” Prifti ia kishte kthyer: “Unë e lashë atë aty, kurse ti ende po e mbanë”.

Lopatat e varkëtarit

Një varkëtar po i kalonte udhëtarët me varkën e tij nga një anë e liqenit në anën tjetër. Udhëtarëve ua kishin tërhequr vëmendjen lopatat e varkëtarit. Në njërin nga lopatat e varkëtarit shkruante besim, kurse në tjetrën të punosh. Udhëtarët me kureshtje e kishin pyetur se çfarë ishte kuptimi i tyre. Ai ishte përgjigjur: “Për të kaluar nga njëra anë e liqenit në tjetrën kam nevojë për të dy lopatat. Të punosh duke besuar. Pa pasur besim asnjë punë nuk vyen. Mungesa e njërës nga këto është sikur të mundohesh ta lundrosh varkën me vetëm një lopatë. Për të arritur suksesin, kemi nevojë për këto të dyja. Përndryshe mbesim aty ku jemi. Nuk arrijmë asesi aty ku dëshirojmë”.

*Tregime nga Mesnevi-ja
Përktheu nga turqishtja: Fatijona Bajraj*

Vërtetim historik i ngjarjes së Gadirrit

Gadiri është burim i pastër që dëlirësia e Islamit të vërtetë buron prej tij. Çdo kush që pohon në këtë të vërtetë dhe e lanë shpirtin e vet brenda dëlirësisë së të vërtetës së tij mbërrin në kulmin sublime të Islamit të vërtetë. Dhe çdo kush që nuk ka sy ose veshë për të parë apo dëgjuar të vërtetën e kësaj ngjarjeje, ai do të përfitojë vetëm zë të paqartë që vjen nga larg.

Gadiri s'është vendi i parë që Profeti (pqmtf) ua prezantoi njerëzve pasardhësin e vet. Ai në vende, raste, shpjegime e komunikime të ndryshme ua kishte treguar njerëzve këtë të vërtetë dhe ua kishte prezantuar liderin e tyre të ardhshëm. Të gjithë ata që patën kontakt të ngushtë me të Dërguarin (pqmtf) dhe nuk ishin të painformuar me ndodhitë në qendrën e pushtetit islam, dinin se Imam Aliu është pasardhësi i drejtpërdrejtë i Profetit dhe njeriu më i dashur dhe më i afërt i tij.

Kalifati nuk ishte një çështje që është injoruar deri në vitin e dhjetë hixhri. Pasardhësi i të Dërguarit (pqmtf) ishte përcaktuar po ashtu në atë ditë kur kishte filluar profetësia në Mekë. Më pas, sidomos në periudhën pas Hixhretit kjo çështje aq shumë u përsërit sa që të gjithë banorët e Medinës e kishin njohur atë. Të gjithë ata kishin dëgjuar për hadithin e Pozitës (menzeleh), Flamurin (rajat), Shpendit (tajr). Hadithin e dy amaneteve (thekalejn) ua kishte mësuar. Shpallja e ajeteve të Dashamirësisë (meveddet), Mallkimit (muhabele) dhe Prijësisë (Vilajet) ishte bërë shkak që drita e personalitetit të Imam Aliut nga dita në ditë të ndriçohej sa më shumë.

Megjithëse hadithi i Gadirrit është një hadith që nuk ka nevojë për prezantim. Të gjitha hadithet që kanë të bëjnë me këtë çështje janë sahih, të njohura dhe tevatur (të plotbesueshme), por hadithi i Gadirrit i tejkalon kufijtë e tevaturit.

Sejjid Sherif Murteza ka thënë:

“Njeriu i cili dyshon në vërtetësinë e këtij transmetimi, është si personi që kërkon argument për saktësinë e luftërave dhe sjelljeve të njohura të Profetit dhe në të vërtetë konsidero-





het si mohues i Haxhit të Lamtumirës. Të gjitha këto gëzojnë të njëjtin rang në të qenët të njohura. Sepse të gjithë dijetarët shiit dhe shkencëtarët e hadithit e kanë transmetuar me vargun e transmetuesve të tyre. Historianët dhe biografët e jetës së Profetit që i transmetojnë ngjarjet e njohura e njohura dhe me famë, po të ketë nevojë për referim, i transmetojnë nga brezi në brez dhe muhaddithinët i kategorizojnë në radhën e haditheve sahih (të vërtetë). Hadithi i Gadirit gëzon një mëvetësi që asnjë transmetim tjetër nuk e posedon. Arsyeja është që transmetimet janë të dylojshme:

Lloji i parë janë transmetimet që nuk kanë nevojë për vargun e transmetimit, si: lufta e Bedrit, Hajberit, Xhemelit, Siffinit dhe të gjitha ngjarjet e njohura që njerëzit dhe gjenerata të ndryshme janë në dijeni për ato. Lloji i dytë janë transmetimet që i nevojiten vargut të pashkëputur të transmetimit, siç janë hadithet që kanë të bëjnë me normat fetare.

Ngjarja e Gadirit është transmetuar në të dy mënyra, d.m.th. megjithëse që është e përhapur dhe gëzon famë dhe nuk ka nevojë për vargun e transmetimit, është transmetuar edhe me vargun e transmetimit. Përveç kësaj, hadithet që kanë të bëjnë me normat fetare janë me një transmetim (një person i ka transmetuar prej të Dërguarit), por hadithi i Gadirit është transmetuar prej shumë transmetuesve”.

I ndjeri Allame Abdel-Husejn Emini i ka përmendur emrat e të gjithë transmetuesve duke shënuar kohën në të cilën kanë jetuar. Ne vetëm ju paraqesim numrin e tyre në çdo shekull dhe lexuesit për informata më të hollësishme mund të referohen në librin e tij “El-Gadir”:

Nga shokët e Profetit
e transmetojnë 110 veta;

Nga dijetarët e shekullit I
e transmetojnë 84 veta;

Nga dijetarët e shekullit II
e transmetojnë 56 veta;

**Nga dijetarët e shekullit III
e transmetojnë 92 veta;**

**Nga dijetarët e shekullit IV
e transmetojnë 43 veta;**

**Nga dijetarët e shekullit V
e transmetojnë 24 veta;**

**Nga dijetarët e shekullit VI
e transmetojnë 20 veta;**

**Nga dijetarët e shekullit VII
e transmetojnë 21 veta;**

**Nga dijetarët e shekullit VIII
e transmetojnë 18 veta;**

**Nga dijetarët e shekullit IX
e transmetojnë 16 veta;**

**Nga dijetarët e shekullit X
e transmetojnë 14 veta;**

**Nga dijetarët e shekullit XI
e transmetojnë 12 veta;**

**Nga dijetarët e shekullit XII
e transmetojnë 13 veta;**

**Nga dijetarët e shekullit XIII
e transmetojnë 12 veta;**

**Nga dijetarët e shekullit XIV
e transmetojnë 19 veta.**

Këtë hadith Ahmed ibn Hanbeli e transmeton me 40 rrugë të transmetimit, Ibn Xherir et-Taberiu me më shumë se 70 rrugë, El-Xhezer el-Mekarri me 80 rrugë, Ibn 'Ukde me 105 rrugë, Ebu Se'id es-Sexhistani me 120 rrugë, Ebu Bekr el-Xhe'abi me 125 rrugë të transmetimit. Ibn Haxher el-Hejthemi në librin e tij "Es-Savail el-Muhrikah" shkruan: "Këtë hadith e kanë transmetuar 30 shokët e Profetit dhe shumica prej rrugëve të tij (të transmetimit) janë sahih (të vërteta) ose hasen (të mira)".

Ibn Magazeli në librin e tij "Menakib" shkruan: "Hadithi i Gadirit është hadith i saktë që rreth 100 sahabë të cilët bëjnë pjesë edhe el-'ashere el-mubeshshere (dhjetë sahabët e përgëzuar me Xhenet) e kanë transmetuar prej të Dërguarit. Ky hadith është vërtetuar dhe s'ka asnjë dyshim. Dhe ky është virtyt që i përket vetëm Aliu dhe askush nuk është ortak në këtë virtyt me të".

Muhamed ibn Xherir et-Taberiu në librin me titull "Er-Ridde 'alel-Harkusijeh" ka shkruar: "Hadithi i vilajetit është transmetuar në shtatëdhjetë e pesë

rrugë". Ebul-Kasim Abdullah Haskani rreth kësaj ngjarjeje ka shkruar librin me titull "De'ahul-Hadat ila edai hakkil-velat". Ebul-Abbas Ahmed bin Se'id bin 'Ukde ka shkruar librin me titull "El-Vilajeh" dhe thotë se ky hadith është transmetuar në 150 rrugë të ndryshme. Ai pas transmetimit të teksteve transmetimeve (rivajeteve) shkruan: "Të gjitha këto libra përpos librit të Taberiu gjenden në librarinë time. Veçanërisht libri i Ibn 'Ukde-s që gjatë periudhës së jetës së tij (shek. III hixhrij) e kanë përtëritur".

Është i rëndësishëm fakti që nga shekulli i dytë dhe më pas kur filloi përcaktimi në mes shkollave juridike (medh'hebeve), asnjëra prej këtyre transmetimeve nuk është prej shiitëve. Në mesin e shiitëve gjithashtu ekzistojnë shumë pak dijetarë që ta kenë transmetuar këtë hadith me dokumente të ndryshme. Rëndësia e hadithit të Gadirit ka arritur në shkallë aq të lartë saqë shumica e dijetarëve islamë kanë shkruar libra të posaçëm lidhur me këtë. Sipas studimit të Allame Abdel-Husejn Em-init, në librin "El-Gadir", deri në kohën e tij janë shkruar gjithsej 26 libra nga dijetarët e shquar lidhur me plotbesueshmërinë (tevaturin) e hadithit në fjalë, ose hulumtimin rreth domethënies së tij. Kjo çështje ka qenë aq e evidente e pranuar dhe e qartë për të gjithë saqë Ehli Bejti (pasardhësit e të Dërguarit) dhe ithtarët e tyre e kanë sjellë atë si dëshmi në raste të ndryshme. Ne hasim në shumë raste të tilla që Imam Aliu (pqmt) në vitet pas Profetit (pqmtf) në tubime të ndryshme, sahabëve duke u betuar në Zotin, iu thoshte: "Vallë, a ju kujtohet se në Ditën e Gadirit, Profeti i Islamit ka thënë: "Men kuntu mevlahu fe-'Alijjun mevlahu – Mevla i kujt jam, edhe Aliu është Mevla i tij", dhe ata (sahabët) betoheshin që një gjë e tillë iu kujtohej.

Sipas kësaj që shkruam, hadithi i Gadirit është një realitet që "dora e hekurt" e mohimit është larg pranisë sakrale të tij dhe kritikë e një numri të vogël të pseudo-dijetarëve nuk e ndotin atë. Mu për këtë arsye, shkrimtari i njohur i librit të Imam Aliut (pqmt), 'Abdul-Fettah 'Abdul-Maksud el-Misri në hyrje të librit "El-Gadir" ndër të tjera shkruan: "Hadithi i Gadirit pa dyshim është një realitet që nuk refuzohet, ai shkëlqen, është i shndritshëm si ndriçimi i ditës, dhe është një prej të vërtetave sublime që është shpërndarë nga zemra e Profetit që ta prezantojë madhësitinë e vëllait, të edukuarit dhe të zgjedhurit prej umetit të tij".

Huazuar nga libri: "Gadiri nga pikëpamja e Ehl-i Sunnetit", autor: Muhammed Riza Xhebbaran, përkthet: Mazllum Aliu, botues: "Asambeja Botërore e Ehli Bejtit", Prizren 2009, fq. 24-29.

Ditëlindja e Imam Ali Rizasë a.s.

“Imami flinte pak natën dhe qëndronte në të shumtën e netëve deri në sabah. Ai agjëronte shumë. Ai agjëronte tre ditë të çdo muaji. Ai thonte se ky është agjërimi i epokës. Ai jepte lëmoshë dhe ndihmonte mjaftë në fshehtësi. Këtë e bënte më tepër në netët e errëta. Kush thotë se ka parë të ngjashëm me Imam Ali Rizanë në këtë veprim mos e beso”.

Lindja, fëmijëria dhe shkollimi

Imam Ali Riza (Rida ose Ridha) lindi më datë 1 janar 766 ose 11 Dhul-Ka'de të vitit 148 të Hixhretit (Emigrimit) të Profetit Muhamed (paqja qoftë mbi të dhe familjen e tij) nga Meka në Medine. Ai lindi në Medine te babai Imam Musa el-Kadhim dhe nëna Ummul-Benin Nexhma.

Periudhën fëmijërore e kaloi nën interesimin dhe përkujdesjen e babait të tij derisa prej tij mori të gjitha njohuritë, diturië, moralet të cilat babai i tij i kishte trashëguar prej paraardhësve të tij (paqja qoftë mbi ta). Babai i tij ka qenë i ditur, imam, udhëheqës i cili drejtonte medresenë e Ehli Bejtit duke e ushqyer me njohuri dhe dijeni të shumta. Po ashtu ai pushtonte në zemrat e muslimanëve pozitën e udhëheqjes dhe drejtimit.

Personaliteti

Para se të bëhej imami (udhëheqësi) i tetë i muslimanëve, ishte fener ndriçimi për udhëzuesit dhe tregues për ata që ndjekin rrugën e besimit të vërtetë. Ka qenë shembullor në morale dhe në vijën e drejtë. Dy nga shumë cilësi morale të personalitetit të tij që transmetohen nga besimtarët e tij janë:

- Një besimtar për devotshmërinë dhe adhurimin e tij shprehet kështu: “Imami flinte pak natën dhe qëndronte në të shumtën e netëve deri në sabah. Ai agjëronte shumë. Ai agjëronte tre ditë të çdo muaji. Ai thonte se ky është agjërimi i epokës. Ai jepte lëmoshë dhe ndihmonte mjaftë në fshehtësi. Këtë e bënte më tepër në netët e errëta. Kush thotë se ka parë të ngjashëm me Imam Ali Rizanë në këtë veprim mos e beso”.

• Një besimtar dhe përcjellës i tij rrëfen: “Unë isha me të nga Medina në Merva. Pasha Zotin, nuk kam parë burrë më besimtar se ai, as përkujtues të Zotit më tepër sesa ai në të gjitha kohët e tij, as person që ia ka frikën Zotit të Madhëruar sesa ai. Ai falte sabahun dhe ulej në vendin e faljes duke bërë tespah Zotit të Madhëruar, e lavdëronte, falënderonte dhe madhëronte Atë, i dërgonte përshëndetje (salavat) Profetit Muhamed (pqmtf) derisa lindi dielli. Pastaj binte në sexhde dhe rrinte për një kohë të gjatë. Pastaj shkonte tek njerëzit i fliste dhe rrinte për një kohë të gjatë. Pastaj shkonte tek njerëzit i fliste dhe i këshillonte ata deri vinte koha e drekës”.

Situata politike në të cilën jetoi

Imam Rizai (pqmt) jetoi atë periudhë të vështirë me të cilën jetoi babai i tij. Ai shikoi fakeqësitë dhe zullumin që iu bënë babait të tij duke shkuar nga në burg tek tjetri. Ndjekjet që i bëheshin prej qeverisë së shtetit abasit. Po ashtu e pa edhe përfundimin dhe ndodhinë e kurtheve dhe masakrimit e ithtarëve të Ehli Bejt, përzënie e tyre, shembjen e shtëpive të tyre, grabitjen e pasurive, burgosjen etj. Të gjitha këto ndodhi Imam Rizai i përjetoi dhe i mbajti hidhërimet e tyre. Në atë kohë ai jetonte nën hijen e babait të tij. Kur Imam Kadhimi ra dëshmor, imameti i kaloi Imam Rizasë.

Situata e keqe politike ndikoi në të gjitha shtresat e umetit në përgjithësi. Për këtë të gjithë u drejtuan tek Ehli Bejt ku udhëheqësit e tyre: Imam Sadiku, Imam Musa Kadhimi dhe Imam Rizai ishin strehim për umetin dhe vend ku grumbulloheshin kundërshtarët e politikave devijuese. Animi kah Ehli Bejt u shtua dhe u forcua më tepër, po ashtu dashuria për ta mbërriti në shkallët më të larta sidomos në kohën e Imam Ali Rizasë.

Fillimi i kryengritjeve

Marrja e pushtetit nga kalifi abasit el-Me'muni, politika e tij, situata e rëndë dhe torturat ishin shtytësit që t'i detyrojnë ithtarët e Ehli Bejt që të bëjnë kryengritje dhe revolucion, dhe të mbrojnë me forcë drejtësinë. Kryengritjet shpërthyen në disa vende të kalifatit abasit. Kalifi Me'mun nuk e gjeti të përshtatshme përdorimin e dhunës por ishte i pajtimit që ithtarëve të Ehli Bejt iu takon e drejta e vilajetit. Këtë e bëri për të bindur njerëzit se ai nuk është si të tjerët dhe të fitojë ndihmues, si dhe për të lehtësuar presionet që gjendeshin në ndërgjegjen e umetit.

Udhëheqësia e shtetit

Rrugëdalja e vetme prej krizës politike siç e parafytyronte kalifi Me'mun ishte që ai t'ia propozonte Imam Rizasë që ky të merrte pjesë në drejtimin e çështjeve të shtetit, që me këtë veprim ai do t'i bashkonte të dyja krahët e fuqishëm, atë të ithtarëve të Ehli Bejt dhe atë të abasitëve në një dorë të vetme. Kalifi Me'mun bëri marrëveshje me Imam Rizanë që ky i fundit ta merr drejtimin e shtetit menjëherë pas vdekjes së kalifit. Të gjithë ishin të lumtur me këtë marrëveshje por ithtarët e Ehli Bejt këtë marrëveshje e shihnin me reserve dhe kishin dyshime se mund të jetë një mashtrim i radhës nga qeverisja abasite. Kalifi Me'mun për ta forcuar më tepër lidhjen me Imam Rizanë, ia dha vajzën e tij Ummu Fadl për t'u martuar me djalin e Imam Rizasë – Muhamed Xhevadin, ndërsa vajzën e tij Ummu Habib e martoi me Imam Rizanë. Këtë e bëri për të bindur njerëzit se ka marrëdhënie të mira mes tij dhe imamet.

Vdekja e Imam Ali Rizasë

Imam Rizai e dinte që herëdokur kalifi Me'mun për interesa të ulëta, do ta thente marrëveshjen, duke u bazuar në atë se ai nuk ishte besimtar, për pozitë vrau vëllain e tij si dhe shërbyesit e vëllait dhe babait të tij. Kështu edhe ndodhi. Kalifi Me'mun vendosi helm në ushqimin e Imam Rizasë dhe e helmoi atë, madje e mbajti të fshehur lajmin e vdekjes së tij. Ai u martirizua më 17 Safer 203 të Hixhretit ose 6 qershor 818 dhe u varros në qytetin Tus të Iranit. Sot ky vend është në qytetin Meshhed.

*O Allah! Bekoje Muhamedin
dhe Familjen e Muh medit (pqmtf)!
Paqja qoftë mbi ty o Imam Ali Riza (pqmt)!*

Lutja e ditës së Kurban Bajramit

- O Zoti im! Kjo është ditë e begatë, ditë e arritjes së shpresave. Në këtë ditë muslimanët janë mbledhur në anët e tokës Tënde, ka ardhur lypësi, kërkuesi, dëshirëshumi e i frikësuari dhe Ti je Sistemuesi i nevojave të tyre. Unë të lutem Ty me bujarinë Tënde, me cilësinë Tënde të dhënies së madhe, me faktin sa e lehtë është për Ty plotësimi i kërkesës time, dhuro paqe dhe shpëtim për Muhammedin dhe familjen e tij.

- Të lutemi Ty o Zoti im! Vetëm ty të takon sundimi, vetëm Ty të takon falënderimi dhe lavdërimi, nuk ka zot tjetër përveç Teje, Ti je i Buti, Bujari, i Dashuri, Dhënësi i madh, Zotëruesi i madhështisë e i nderimit, Shpikësi i qiejve dhe i tokës, sido që të pjesëtosh ndërmjet robëve Tuaj besimtarë të mirat e shëndetin, begatinë e udhëzimin, punën me bindje ndaj Teje, ose çdo të mirë që u jep atyre, me të gjitha këto i udhëzon ata për te Ti, i ngren ata në gradë pranë Teje. Me këto Ti i jep atyre mirësi të kësaj bote e të botës së ardhshme, të lutem që pjesa time në këto mirësi të jetë e bollshme.

- Unë të lutem ty o Zoti im! Vetëm ty të takon sundimi dhe vetëm për Ty është falënderimi e lavdërimi, nuk ka zot tjetër përveç Teje, dhuro paqe dhe shpëtim për Muhammedin, për robin Tënd, për më të përzgjedhurin Tënd, për të mirin e njerëzve Tuaj dhe për pjesëtarët e familjes së Muhammedit, fisnikët, të pastërtit, të mirët, paqe e shpëtim aq të shumtë sa nuk ka fuqi ta numërojë askush përveç Teje. Të lutem na bëj pjesëtarë në të mirën e kujdo prej robëve Tuaj besimtarë që të lutet Ty në këtë ditë. O Zot i botëve! Të lutem na i fal gjynahet ne e atyre, me të vërtetë vetëm Ti je Fuqploti mbi të gjitha sendet.

- O Zoti im! Në Ty e kam mbështetur kërkesën time, te Ti e parashtroj sot varfërinë time, nevojën që kam dhe mjerimin ku jam. Unë me faljen Tënde të gjynaheve e me mëshirën Tënde jam më i siguruar se me punën time, falja e mëkateve prej Teje dhe mëshira Jote janë tepër të mëdha ndaj gjynaheve të mija, dhuro paqe e shpëtim për Muhammedin e për familjen e Muhammedit, Ti mere përsipër kryerjen e të gjitha nevojave të mia, me fuqinë Tënde që ke mbi ato, me lehtësinë e madhe që ke Ti për këto, me nevojën e madhe që kam unë për Ty, me atë që Ti nuk ke asnjë nevojë për mua. Në fakt mua çdo mirësi më ka ardhur vetëm prej Teje, askush përveç Teje nuk e ka larguar ndonjëherë të keqen prej meje dhe çdo punë të kësaj bote e të botës së ardhshme unë nuk e shpresoj prej ndonjë tjetri por vetëm prej Teje.

- O Zoti im! Kush planifikon, mobilizohet, bën gati pajimet dhe përgatitet të shkojë te ndonjë i krijuar, me shpresë se te ai do të marrë dhuratat të zakonshme e dhuratat të mëdha, se te ai do të arrijë kërkesat e do të marrë sipër meritës, për te Ti. O Sunduesi im! Sot është planifikimi im, mobilizimi im, bërja gati e pajimeve dhe përgatitja ime, duke shpresuar në faljen Tënde, në dhuratat e Tua, në arritjen e kërkesave te Ti e në marrjen e shpërblimit prej Teje.

- O Zoti im! Dhuro paqe dhe shpëtim për Muhammedin e për familjen e Muhammedit, në këtë ditë mos më lër shpresëhumbur, o Ti që nuk të rëndojnë kërkesat e shumta të lypësit, o Ti që nuk të pakësohet asgjë nga dhëniet, unë nuk kam ardhur te Ti i siguruar me punën time të mirë që parashtroj, as nuk kam shpresuar



në ndërmjetësinë e ndonjë të krijuari, me përjashtim të ndërmjetësimit të Muhammedit e të Ehli Bejtit të tij, mbi atë e mbi ata qoftë paqja e shpëtimi Yt.

- Erdha te Ti duke pohuar kundër vetes fajin tim e punën time të keqe, erdha te Ti me shpresë të madhe në faljen Tënde, erdha të kërkoj faljen sepse vetëm Ti i fal mëkatarët, Ty nuk të pengon zhytja e tyre në gjynahe të mëdha që të shikosh në ata me mëshirë e me falje gjynahesh.

- O Ti që e ke mëshirën tepër të madhe! Ti që e ke faljen shumë të gjerë, o Madhështor, o Madhështor! O Bujar, o Bujar! Dhuro paqe e shpëtim për Muhammedin e për familjen e Muhammedit, më kthe mua mëshirën Tënde. Me mirësinë Tënde më shto nga mirësitë e Tua dhe me faljen Tënde të gjynaheve bëhu me mua sa më i gjerë.

- O Zoti im! Pozita e kalifëve të Ty, e të përzgjedhurve Tuaj, vendi i të besuarve të Tu është në gradën më të lartë, ashtu siç i ke përveçuar Ti me atë pozitë e me atë vend, me dhunë ua hoqën atyre këto pozita dhe Ti je i Gjithmundëshmi për këtë, urdhëri Yt nuk mposhtet, nuk tejkalohet ajo që është vendosur përfundimit në

sistemin Tënd, por bëhet vetëm si të dëshirosh Ti dhe ku të dëshirosh Ti, për atë e në atë që vetëm Ti e di më mirë, pa akuzuar krijesat Tuaja e as vullnetin Tënd, deri të përzgjedhurit Tuaj, kalifët Tuaj të mposhtur, të shtypur e të dhunuar të kthehen e të shikojnë gjykimin Tënd të ndryshuar, librin Tënd të hedhur më një anë, detyrimet Tuaja të devijuara nga qëllimi i ligjit të fesë Tënde dhe rrugën e Profetit Tënd të lënë.

- O Zoti im! Mallkoji armiqtë e tyre, të përparshmit e të mbrapmit, të gjithë ata që janë të kënaqur me veprimet e tyre, ndjekësit e pasuesit e tyre.

- O Zoti im! Dhuro paqe dhe shpëtim për Muhammedin e për familjen e Muhammedit, vetëm Ti je i Falënderuari, i Lavdishmi, mëshira Jote, begatitë Tuaja e përshëndetjet Tuaja qofshin mbi të përzgjedhurit Tuaj Ibrahimin e mbi familjen e Ibrahimit, shpejtoje për ata largimin e brengave, ardhjen e qetësisë, ndihmën, mundësinë e përkrahjen.

- O Zoti im! Më bëj prej atyre që pohojnë për Ty Njëtimin e prej atyre që besojnë në Ty, prej atyre që vërtetojnë të Dërguarin Tënd e imamët, bindje ndaj të cilëve Ti e ke bërë detyrim; më bëj prej atyre që këto i arrijnë vetëm me ndërmjetësinë e tij, pranoje këtë lutje o Zot i botëve!

- O Zoti im! Zemërimin Tënd nuk e spraps asgjë përveçse butësia Jote, ashpërsinë e zemërimit Tënd nuk e spraps asgjë përveç faljes Tënde, prej dënimit Tënd nuk më shpëton asgjë përveç mëshirës Tënde, mua nuk më shpëton asgjë përveç strehimit të Ti dhe përulja para madhështisë Tënde. Dhuro paqe e shpëtim për Muhammedin e për familjen e Muhammedit, dhuro për ne o Zoti im nga ana Jote heqjen e brengave me fuqinë që Ti ringjallë njerëzit e vdekur e me të cilën Ti përhap vdekjen e vendit.

- O Zoti im! Mos më vdis të brengosur dhe shtyje vdekjen për mua, që të më bësh të ditur pranimin e lutjes time, më mëko (më ushqe) me shijen e shëndetit deri në fundin e jetës time, mos bëj që armiku im të qeshë me mua, mos i jep atij mundësi të më vrasë mua dhe as mos e bëj atë sundues mbi mua.

- O Zoti im! Nëse Ti më lartëson, cili do të më ulë poshtë? Nëse Ti më ul poshtë, cili do të më ngrejë lart? Nëse Ti më nderon, cili do të më fyejë? Nëse Ti më fyen, cili do të më nderojë? Nëse Ti më mundon, cili do të më mëshirojë? Nëse Ti më shkatërron, cili është ai që do të largojë Ty prej robit Tënd, ose që do të marrë Ty në pyetje për çështjen e tij? Unë e di mirë se në vendimin Tënd nuk ka padrejtësi, as në dënimin Tënd nuk ka nxitim. Në të vërtetë nxiton vetëm ai që ka frikë se gjëja i del nga dora, në të vërtetë për padrejtësi ka nevojë vetëm i pafuqishmi, kurse Ti o Zoti im je tepër i lartësuar dhe qëndron mbi çdo lartësi nga të tilla punë.

- O Zoti im! Dhuro paqe dhe shpëtim për Muhammedin e për familjen e Muhammedit, mos më bëj mua qëllim të sprovës, as shenjë të hakmarrjes Tënde, shtyje për më vonë punën time, zgjeroje hapësirën e veprimit me mua, bëj që unë të kem sa më pak rrëshqitje, mos më lësho mbi mua pesim mbi pesim, ndryshe do të dalë sheshit dobësia ime dhe mundësia ime e pakët në përballimin e sistemimin e punëve, si dhe poshtërimi im para Teje.

Lutje e shpëputur nga libri me lutje "Sahife Sexhadije", autor: Imam Zejnul-Abidini, përkthyes: Haxhi Selim Stafa, botues "Shoqata Flladi", Tiranë 2008, fq. 402-412.

Lutja e Imam Husejnit

në Ditën e Arafatit

Nga lutjet më në zë të kësaj dite është edhe lutja e zotërisë së dëshmorëve, Imam Husejnit (paqja qoftë mbi të). Transmetohet që Imam Husejni së bashku me familjen, djemtë dhe shërbyesit e tij, derisa qëndronte përballë malit në drejtim të Kibles, ngriti duart para fytyrës, duke marrë trajtën e të uriturit që kërkon ushqim dhe tha:

“Falënderimi e lavdërimi i takojnë vetëm Allahut.

Nuk ka sprapës për vendimin e Tij, nuk ka ndalues për dhënien e Tij e nuk ka shpikës të shpikë si Ai.

Për Atë asgjë nuk mbetet e panjohur e tek Ai nuk humbin gjërat e lëna në mirëbesim.

Ai është Shpërblyesi i çdo mjeshtri, Veshësi me rrobën e krenarisë i çdo të kënaquri me mirësinë e Allahut, Mëshiruesi i çdo të përuluri, Zbritësi i dobive e i Librit gjithëpërfshirës me dritën vezulluese.

Ai është Dëgjuesi i lutjeve, Sprapës i pësimeve, Lartësues në grada, Shtypës i tiranëve.

Nuk ka zot tjetër përveç Tij; nuk ka asnjë send të jetë i barabartë me Atë; asnjë send nuk i ngjan Atij. Ai është Gjithëdëgjuesi, Gjithëshikuesi, i Buti, i Gjithin-formuari dhe mbi çdo send Ai është Fuqiplotë.

O Zoti im! Unë kam dëshirë të madhe të arrij pranë Teje; unë dëshmoj se vetëm Ti je Zoti; unë pohoj se me të vërtetë Ti je Zoti im dhe se vetëm te Ti është kthimi im.

Ti më fillove mua me mirësinë Tënde para se unë të isha send që përmendet; Ti më krijove mua prej dheut, pastaj më dhe formën materiale në mitër qysh në rrjedhën e ditëve të kaluara dhe të shekujve që nuk mbahen mend.

Me mëshirën Tënde e me mirësinë Tënde për mua, Ti nuk më nxorre mua në shtetin e prijësve mohues, të cilën kanë shkelur e kanë thyer besën Tënde dhe kanë përgënjeshtuar të dërguarit e Tu; porse Ti më nxorre mua në vendin që ishte përpara meje, ishte në udhëzimin e rrugës së drejtë, udhëzim në të cilën Ti më krijove mua dhe atë rrugë Ti e bërë të lehtë për mua. Edhe më parë Ti ishe i mëshirshëm ndaj meje me shpikjen Tënde të përsosur e të pajisur me të gjitha mirësitë.

Pasi e fillove krijimin tim nga një pikë lëngu që hidhet, Ti më vendose në tre errësirat në mes mishit, gjakut e lëkurës. Ti nuk bërë që unë të jem dëshmues i krijimit tim, Ti nuk le në dorën time asgjë nga çështjet e mia.



Pastaj Ti më nxorre mua, ashtu siç kishe nxjerrë edhe ata që kishin dalë para
meje në udhëzimin e rrugës së drejtë; më nxorre në këtë botë të plotë e të
përsosur.

Ti më ruajte mua në djep kur isha foshnje e fëmijë, Ti më ushqeve me
qumësht të përshtatshëm, Ti më bëre mua të dashur në zemrat e gjidhënë-
seve dhe Ti më vure nën kujdestarinë e nënave të mëshirshme. Ti më ruajte
prej goditjeve të xhinëve e Ti më shpëtove nga teprimi e pakësimi.

I Lartë je Ti, o Mëshirëmadh, o i Gjithëmëshirshëm,
derisa unë fillova të flas, Ti plotësove për mua llojet e mirësive të mëdha.

Ti më rrethove me përkujdesje të shtuar për çdo vit,
deri më bëre të plotësuar dhe e përsose fuqinë time.

Ti e bëre detyrë për mua argumentin Tënd kur më inspirove njohjen
Tënde dhe më tërhoqe vëmendjen me urtësinë e krijimit Tënd.

Ti më ndërgjegjësove me mrekullitë e mëdha të krijimit Tënd
që Ti i ke shpërndarë në qiellin e në tokën Tënde.

Ti më tërhoqe vërejtjen për të të falënderuar Ty dhe për të të përmendur Ty.
Ti më vure detyrë bindjen ndaj Teje e adhurimin për Ty.

Ti më bëre të kuptoj atë me të cilën erdhën të dërguarit e Tu dhe bëre të lehtë
për mua të pranoj kënaqësinë Tënde; bëre për mua të mira në të gjitha gjërat
dhe kjo në sajë të ndihmën Tënde e të butësisë Tënde.

Qysh kur Ti më krijove mua prej baltës më të mirë dhe kurrë s'reshte, o Zoti
im, duke më dhënë mirësitë njëren pas tjetrës, Ti më furnizove me të gjitha
llojet e ushqimeve e të veshjeve të bukura, me mirësinë e dhënies Tënde të
madhe e gjithnjë më të madhe për mua me bamirësinë Tënde të përhershme,
derisa i plotësove për mua të gjitha mirësitë...

*Lutje e shpëputur pjesërisht nga libri me lutje "Çelësat e Xheneteve",
autor: Shejh Abbas El-Kummi, përkthyes: Haxhi Selim Stafa,
botues "Shoqata Flladi", Tiranë 2014, fq. 530-534.*

Të folurit e fjalëve të turpshme

"Besimtari (mu'mini) nuk tallet, nuk kritikon, nuk fajëson dhe nuk flet keq për të tjerët"



Përdorimi i fjalëve të këqija dhe të folurit e fjalëve të turpshme është një shprehje e keqe. Personat që i përdorin sharjet duke folur çfarëdo që u bie ndërmend, rrallë u përmbahen fjalëve të folura. Ata e ndryshojnë shumë shpesh mendjen e tyre. Ata i përdorin fjalët e këqija dhe i gjejnë të metat e të tjerëve pa pasur ndonjë arsye për këtë. Ata u shkaktojnë lëndime të tjerëve përmes fjalëve të tyre të papërgjegjshme. Përdorimi i fjalëve të këqija është haram dhe konsiderohet një mëkat i madh. I Dërguari i Islamit, ka thënë: "Allahu ua ka ndaluar Xhenetin atyre që i përdorin lapërdhitë. Po ashtu, ekziston edhe mallkimi ndaj atyre që shajnë, që janë të paturpshëm dhe të pafytyrë, dhe atyre do t'u ndalohet hyrja në Xhenet. Çkado që personat e tillë flasin për të tjerët, e bëjnë këtë pa penduar dhe asnjëherë nuk mërzhiten për atë se çfarë mendimi kanë të tjerët për të" (Usul el-Kafi, vëll. 2, f. 323).

Imam Xha'fer Sadiku ka thënë: "Mallkimi, sharja dhe paturpësia janë shenjat e hipokrizisë (nifak) dhe të pabesimit" (Usul el-Kafi, vëll. 2, f. 325). Allahu thotë në Kuranin e Shenjtë: "Mjerë për ata që flasin për dobësitë e të tjerëve dhe kënaqen duke i përqeshur të tjerët" (Surja el-Humeze, ajeti 1). Personat që i përdorin sharjet, në përgjithësi janë inferior dhe mendjengushtë. Ata i përfitojnë armiqtë përmes të folurit të tyre të pamatur. Njerëzit i urrejnë ata. Ata mundohen të rrinë larg prej tyre dhe i shmangen shoqërimit të tyre. I Dërguari i Islamit, ka thënë: "**Më i keqi ndër njerëzit është ai, fjalët e të cilit nuk pëlqehen nga të tjerët dhe nga takimi i të cilit i shmangen**" (Usul el-Kafi, vëll. 2, f. 325).

Imam Xha'fer Sadiku, ka thënë: "Kur njerëzit nuk duan as t'i dëgjojnë fjalët e një personi, fati i tij do të jetë Xhenenemi!" (Usul el-Kafi, vëll. 2, f. 327). I Dërguari i Islamit, ka thënë: "Besimtari (mu'mini) nuk tallet, nuk kritikon, nuk fajëson dhe nuk flet keq për të tjerët" (El-Mehajjat el-Bejda, vëll. 3, f. 127).

Sipas natyrës, fëmija nuk është i prirë për fjalët e turpshme. Ai mund ta mësojë këtë prej prindërve, vëllezërve, motrave, shokëve dhe duke luajtur në shkollë. Por, ndikimi më i madh do të jetë prej qendrimit të prindërve. Prindërit mund të jenë shembulli më me ndikim për fëmijët. Prindërit jo vetëm që janë përgjegjës për sjelljen e tyre, por kanë përgjegjësi shumë të rëndësishme për trajnimin e duhur të fëmi-

jëve të tyre. Prindërit janë ata që ose i bëjnë fëmijët të sjellshëm e të butë, ose të pafytyrë. Disa prindër, duke bërë shaka apo kur janë të zemëruar u flasin fëmijëve të tyre fjalë të këqija. Në këtë mënyrë, ata u japin një trajnim të gabuar fëmijëve të tyre. Janë disa shtëpi ku përdorimi i fjalëve të këqija është praktikë e rëndomtë.

'Biri i qenit', 'nëna e qenit', 'idiot', 'budalla', 'gomar i pandjenjë', 'shtazë', 'i paturp' dhe disa fjalë të tjera janë emrat që i emërtojnë njëri-tjetrin personat e shtëpisë gjatë bërjes së shakasë apo gjatë zemërimit. Prindërit, detyra e të cilëve është parandalimi i gabimeve të fëmijëve të tyre, vetë janë duke kryer vepra të tilla të gabuara dhe duke i inkurajuar fëmijët që ta ndjekin shembullin e tyre. Ata e fyejnë dhe e shajnë njëri-tjetrin përpara fëmijëve, pa menduar për pasojat.

Prindërit i përqeshin fëmijët dhe e përdorin gjuhën e pamoralshme me ata. Si mund të presin prindërit e tij që fëmijët e tyre të rriten në persona miqësorë dhe të respektuar. Ata duhet të kuptojnë se fëmija mund të tregohet edhe më i keq sesa vetë ata. Ata duhet të mbajnë në mend se herët apo vonë do të shohin se fëmija është duke e përdorur gjuhën e njëjtë që e ka dëgjuar sa e sa herë prej prindërve të tij. Pastaj, asnjë sasi e predikimit apo e rrahjes nuk mund ta reformojë fëmijën. Mjeti më i mirë i shërimit është që prindërit së pari ta reformojnë me kohë vetveten para se të bëhet tepër vonë.

Shumë herë, fëmija e mëson këtë shprehje të keqe prej shokëve të tij. Prindërit duhet t'i mbajnë të hapur sytë dhe veshët e tyre ndaj sjelljeve të tilla të fëmijëve të tyre dhe ta evitojnë para se të lëshojnë rrënjë. Ata duhet të kërkojnë prej fëmijëve të tyre që të mos shoqërohen shumë me fëmijët e tillë.

Nëse vëreni se fëmija juaj është duke i shqiptuar fjalët e tilla fyese, atëherë mos qeshni dhe mos rritni të qetë. Edhe përmes britmës dhe kërcënimeve situata e tillë nuk mund të tejkalohet. Kjo metodë mund të dështojë. Mënyra më e mirë për të korrigjuar fëmijën është biseda e butë me fëmijën dhe shpjegimi për efektet e këqija të përdorimit të fjalëve të këqija.

Huazuar nga libri: "Principet e rritjes së fëmijëve", autor: Ibrahim Amini, përkthyes: Gëzim Gërgi, botues: Sh.F. "Ehli Bejti", Prizren 2008, f. 223-225.

Metoda e Kurani në fizioterapi

Lind pyetja: Si mundi Kurani ta ndryshonte psikologjinë dhe personalitetin e arabëve?

1. Besimi se Zoti është Një

Gjëja e parë që Kurani donte të ndryshonte tek arabët ishte besimi i tyre. Duke u nisur nga kjo, qëllimi i ajeteve që u shpallën në fazën e parë të ftesës islame në Mekë, ishte besimi në një Zot. Metoda më e mirë e Kuranit është në gjuhësinë e tij. Arabët nuk e kanë parë më parë shembullin e tij. Njëkohësisht, ai është sjellë edhe për faktet logjike e bindëse të tij, në trajtimin e temave e të dispozitave, në përmendjen e historive dhe në përdorimin e fjalëve të urta për shpjegimin dhe zbërthimin e kuptimeve. Për të krijuar interes në të mësuar janë përdorur metoda nxitëse (inkurajimi) dhe kërcënim. Është përdorur përsëritja e disa kuptimeve për përf forcimin e tyre në mendje. Të gjitha këto, duke i përmbledhur, kanë pasur ndikim të madh në fe dhe në besimin në një Zot. Besimi në një Zot është hapi i parë për të krijuar ndryshime të mëdha në personalitet. Besimi sjell një forcë të madhe shpirtërore te njeriu, që ai e kupton në brendësi të tij. Besimi në një Zot i ndryshon njerëzit, jetën dhe gjithë universin. Ai i jep një kuptim të ri jetës dhe e bën njeriun që të mbajë përgjegjësi për të. Njëkohësisht bën që zemra e tij të mbushet me dashuri për Allahun, të Dërguarin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), për njerëzit që e rrethojnë dhe për të gjithë njerëzimin.

2. Devotshmëria

Devotshmëria është ndjekëse e besimit. Devotshmëri do të thotë që njeriu ta largojë veten nga gjynahet dhe eta detyrojë atë që të jetojë sipas udhëzimeve, për të cilat Allahu dhe i Dërguari i nderuar (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) na këshillojnë në Kuran dhe hadith. Zbatimi i urdhrave të Zotit dhe largimi nga të ndaluara e Tij, do të thotë devotshmëri.

Kuptimi i devotshmërisë mund të përmbledhet në faktin se njeriu është sundues i dëshirave, i pasioneve dhe i kënaqësive të tij. Ai i përdor këto, vetëm aq sa e ka lejuar dispozita islame dhe duke mos i kaluar kufijtë. Devotshmëri nuk do të thotë që njeriu të shtypë (apo të shuajë) dëshirat e lindura (natyrore), por vetëm që të dijë se si t'i kontrollojë ato (dëshira), të mos e lkalojë cakun e sheriatit

(dispozitës). Në punët e tij, njeriu, njëkohësisht, duhet të jetë në kërkim të së vërtetës, të drejtësisë dhe të kryerjes së amanetit, të sillet mirë me njerëzit dhe të ketë kujdes që të mos i sulmojë apo t'i dhunojë ata. Devotshmëri do të thotë që njeriu t'i zbatojë në mënyrën më të mirë të gjitha punët që i janë caktuar. Veprat e tij ai i kryen për të marrë kënaqësinë e Zotit dhe për të marrë shpërblim prej Tij. Ai përpiqet të përmirësojë sjelljen e tij e të marrë sa më shumë njohuri.

Devotshmëria është një forcë, e cila bën që njeriu të drejtohet drejt veprave të mira, të rrisë moralin e tij shpirtëror, të largohet nga sjelljet e papëlqyeshme dhe të devijuara. Që të arrihet kjo, njeriu duhet të luftojë me egon e tij dhe të mos u bindet dëshirave të kota. Devotshmëria është një nga shkaqet më kryesore për rritjen dhe plotësimin e një personaliteti. Ajo bën që njeriu të ngrihet dhe të arrijë në majat më të larta të tij.


“O ju (ithtarë të Librit) që besuat (në Musain dhe Isain), ruajuni Allahut dhe besoni në të Dërguarin e Tij (Muhamedin), se ai do t’ju dhurojë pjesë të dyfishtë nga mëshira e Vet, do t’ju jape dritë, me ndihmën e së cilës do të ecni dhe do t’ju falë; Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë” (Surja el-Hadid, ajeti 28).

“O besimtarë! Nëse i frikësoheni Allahut, Ai do t’ju japë aftësinë e të gjykuarit drejt, do t’ju lirojë nga gjynahet tuaja dhe do t’ju falë. Allahu zotëron mirësi të madhe” (Surja el-Enfal, ajeti 29).

“O besimtarë! Frikësojuni Allahut dhe thoni vetëm të vërtetën. Ai do t’ju bekojë veprat tuaja dhe do t’ju falë gjynahet” (Surja el-Ahzab, ajetet 70-71). “...Ai që i frikësohet Allahut, Ai do t’ia lehtësojë çështjen” (Surja et-Talak, ajeti 4).

Cili është hapi i parë dhe më i rëndësishëm për ndryshimin e personalitetit të një personi?

*(Vazhdon në numrin e ardhshëm të revistës Vlëra)
Huazuar nga libri: “Kurani dhe Psikologjia”, autor:
Muhammed Uthman Nexhati, përktheu: Redis Sheko,
botues: “Fondacioni i Kuranit”, Tiranë 2013, fq. 296-298.*



Ultratingulli apo Mamografia

Shkuarja e herëpashershme e gruas për kontrollime mjekësore, është ndihma më e mirë që të zbulohet kanceri i gjirit.

Ballafaqimi me diagnozën e karcinomës së gjirit nuk është përvojë e këndshme. Kanceri i gjinjve është tumori më i shpeshtë malinj dhe një nga shkaktarët e vdekjes së parakohshme të grave. Përvoja shumëvjeçare ka treguar se, nëse zbulohet me kohë, kanceri i gjirit mund të shërohet suksesshëm tek më shumë se 90% të rasteve. Mjekëve mund t'u ndihmojnë më së shumti vetë pacientet, duke shkuar me kohë për kontrollimin e gjinjve.

Nuk ka parandalesë

Kur gruaaja të vërejë vetë ndryshime në gji, në afat prej pak ditësh duhet të shkojë për kontrollim. Përveç mamografisë, në klinika bëhen edhe analiza të tjera, siç është ultratingulli i gjinjve, por edhe rezonanca magnetike, nëse ekzistojnë indikacione të caktuara për analizë të tillë. Gati çdo ditë në spitale bëhen punkSIONET e lezieve, në masë të madhe nën mbikëqyrjen e ultratingullit dhe një pjesë më e vogël nën kontrollim të mamografisë, pastaj bëhen punkSIONET citologjike dhe e ashtuquajtura kore e biopsisë. Nëse është e nevojshme, bëhen edhe të ashtuquajturat biopsi me

vakuum.

Që të caktohet diagnoza sa më e saktë, gjatë orarit të punës, radiologu e bën ultratingullin e gjinjve, ndërsa të gjitha rezultatet gjithëherë i lexojnë dy mjekë. Kur bëhet fjalë për atë se sa e rëndësishme është diagnostika dhe a mund të ndalohet karcinoma e gjirit, profesionistët thonë se shfaqja e kancerit të gjirit, mjerisht, nuk mund të pengohet, sepse nuk ka mënyrë se si të ndalohet krijimi i saj. Sipas rregullit, karcinoma është e paracaktuar gjenetikisht dhe është e njohur se rrezikut më të madh i ekspozohen personat që kanë histori familjare të kësaj sëmundjeje.

Zbulimi i sigurt


Meqë me anë të mamografisë nuk mund të zbulohen të gjithë karcinomët, një pjesë e pacienteve udhëzohen për analiza të mëtejshme. Në fakt, madje 15% e karcinomave nuk mund të vërehen me mamografi, sidomos kur gjinjtë janë të dendur, fjala është për gratë e reja, gjinjtë e të cilave janë të përmbushur me gjëndrra. Te gjinjtë e tillë hijet e karcinomave ngatërrohen me hijet e indit

të gjëndrrave. Nëse bëhet fjalë për gjinj të dendur, pacientet, veç mamografisë, udhëzohen edhe për ultratingull, ku shihen leziyet, dhe, nëse është e nevojshme, mund t'u bëhet punktimi e biopsia dhe vetëm atëherë diagnoza do të jetë e sigurt. Mamografia është e sigurt nëse gjiri është i mbushur me ind dhjamor, që është rasti te gratë në moshë. Te këto raste me siguri mund të shihen ndryshimet, edhe nëse janë vetëm disa milimetërshe. Te shumë raste diagnozat e ultratingullit dhe të biopsisë në fund tregojnë se nuk është fjala për karcinomën. Mjekët thonë se shumë gra gjatë kontrollimeve të këtilla dhe pritjeve të rezultateve, përjetojnë tensione psikike, por të gjitha këto analiza janë të domosdoshme dhe e vetmja mënyrë që të jenë të sigurta se karcinoma është zbuluar në fazë shumë të hershme dhe se ndryshimet janë – beninje.

Disa tipa të kancerit

Veç kësaj, profesionistët theksojnë se gjithnjë më e madhe është shkalla e shërimit nga sëmundja e karcinomës së gjirit dhe se sëmundja po shërohet

shumë mirë, por po kështu është e rëndësishme edhe të thuhet se karcinoma nuk është një sëmundje, sepse ekzistojnë shumë tipa – që nga të ashtuquajtura duktale invazive dhe lobulare invazive, deri tek ato të ashtuquajtura in situ, të cilat kanë mbetur në kanalet qumështore dhe nuk janë zgjeruar më tej. Brenda këtyre nëntipave histologjikë, ekzistojnë edhe disa tumorë që janë më shumë ose më pak invazivë. Disa kanë receptorë hormonalë më të fortë ose më të dobët, ose kanë prognozë më të mirë ose më të keqe. Karcinoma e madhe e tipit të ngadalshëm mund të shërohet mirë, ndonjëherë tumorët e vegjël, nëse janë agresivë, mund të zgjerohen shpejt. Mirëpo, sot ka ilaçe onkologjike, me ndikim të mirë, prandaj me radioterapi të mirë, jeta e pacientes mund të zgjasë mjaft. Megjithatë, më e rëndësishmja është që sa më herët të zbulohet tumori, ndërsa mjekët janë të parët që pacientes duhet t'ia komunikojnë lajmin e keq. Po kështu, është me rëndësi që pacientet menjëherë të lidhen me gratë e tjera që kanë pasur përvojë të ngjashme. Kur të shohin se shumica e tyre po jetojnë me kualitet, pa marrë parasysh sëmundjen, zbutet depresioni fillestar.





Fjalimi i Imam Zejnul-Abidinit në Medine rreth ngjarjeve në Qerbela

Imam Ali ibn Husejni (Zejnul-Abidini ose Imam Sexhadi) paqja qoftë mbi të) mbajti një fjalim në rrethinat e Medines dhe me të cilin i informoi medinasit në lidhje me gjërat që i kishte parë gjatë kësaj kryengritjeje. Imam Ali ibn Husejni e lavdëroi Zotin dhe e falënderoi atë për vuajtjet e mëdha që i kishte përjetuar. Më pas, i përshkroi ngjarjet e Qerbelasë me disa fjali. Në këtë fjalim të tij të shkurtër dhe të përpiktë, ai tha:

“Lëvdatat i takojnë Zotit! Ai na bëri të durojmë vështirësi të mëdha. Islami ka pësuar një plagë të madhe. Babai im Eba Abdullahu (Imam Husejni), të afërmit dhe përkrahësit e tij u vranë. Gratë dhe fëmijët e tij u zunë robër. Koka e prerë e tim at u ngul në krye të një shtize dhe u shëtit nëpër qytetet muslimane”.

Nga ky fjalim mund të kuptohet lehtësisht se Imami nuk fliste vetëm për ta shprehur pikëllimin e tij dhe vetëm për të krijuar një atmosferë prekëse. Ai dëshironte t'i çnderonte armiqët e Ehl-i Bejtit dhe ta zbulonte shtypjen e tyre me disa fjali të shkurta. Në vijim të fjalimit të tij, ai tha:

“O njerëz! Ne u trajtuam si të ishim mohues të besimit, ndonëse s'kishim kryer ndonjë mëkat dhe s'e kishim dëmtuar Islamin. Për Zotin, sikur i Dërguari i Zotit (s.a.a.) t'u kishte urdhëruar të luftonin kundër neve, ata s'do të bënë më pak nga ç'kanë bërë”.

Fjalimi i Imami mori fund me këto fjali. Pjesëtarët e familjes së tij u kthyen në shtëpitë e tyre. Ata e gdhendën mbi emrin e fisit Hashim lavdinë dhe nderin e vetëflijimit për hir të së vërtetës, ndërkohë që emrat e armiqve të tyre i vendosën përjetësisht në kategorinë e tiranëve dhe shtypësve. Me dëshminë historike që ua lanë trashëgim brezave të ardhshëm, ata e ruajtën përjetësisht lavdinë e tyre, duke e bërë të paharrueshëm edhe çnderimin e armiqve që i vranë. Tani jo gjithkush mund të manipulojë me historinë, t'ia heqë fisit Hashim këtë lavdi ose ta largojë çnderimin e disave. Fjalimet që Ehl-i Bejti i mbajti në rrugëtimin ndërmjet Medines, Mekkes, Irakut dhe Sirisë, janë shënuar qartë në faqet e historisë. Andaj, tashmë s'ka mbebur hapësirë për t'i ndryshuar faktet historike dhe për ta ndryshuar pozitën e martirëve që vdiqën në rrugë të Zotit.

Këta njerëz të sinqertë dhe sakrifikues nuk mund të largohen nga lavdia e tyre dhe tashmë njerëzit gënjeshtarë e shtypës nuk mund të prezantohen si njerëzorë dhe të virtytshëm. Për sa kohë që dëshmitë historike për të kaluarën të ekzistojnë, ato do të flasin për pastërtinë, besimin, virtytin dhe devotshmërinë e Imam Husejnit e të ndjekësve të tij, duke e mbajtur gjithnjë gjallë kujtimin e shtypjes dhe egoizmit të armiqve të tyre.

Huazuar nga libri: “Qerbelaja, një vështrim historik”, autor: Dr. Ibrahim Ajeti, përkthyes: Numan Mustafa, botues: Fondacioni “Gnosa”, Tëtoevë 2018, fq. 209–210.



Gratë më të nderuara të Xhenetit

Asia quhej bashëshortja e Faraonit famëkeq
Sepse ai kishte marrë për mësues një dreq,
Ishte ajo që propozoi ta adaptonin Musanë,
Asaj Zoti ia kishte dëgjuar e pranuar du'anë.
Merjemja ishte gruaja më e dëlirë që ekzistoi,
E lindur mrekullisht, sikurse jetën që e jetoi,
Ruajtja e nderit të saj kishte shumë përgjegjësi,
Jeta e saj u ballafaqua me sprova dhe peripeci,
E lindi njeriun më të pastër që njerëzimi e njohu,
Merrni shembuj te ai e ajo, dhe me ta krenohu!
E ai që s'e ka kuptuar, i themi që tash: zgjohu!
Hadixhe quhet gruaja e Profetit Muhamed,
Ajo i besoi e para kur ai u shpall për profet,
Dashuri dhe besim tregoi për 25 vite me radhë,
Ia dhuroi gjashtë fëmijë, që të gjithë faqebardhë,
Xheneti iu garantua nga Zoti sa ishte gjallë,
E kur vdiq, Profeti për të shumë u përmallë.
Fatimja ka qenë një nga vajzat e Profetit,
Ajo është prijëse e grave të Xhenetit,
Trashëgimtarë la Hasanin e Husejnin,
I donte shumë sepse si yjet shkëlqenin,
Me karakterin e saj është dalluar,
E braktisi këtë botë e përmalluar.

Autor: Besmir Yvejsi

*Shkëputur nga libri me poezi fetare dhe atdhetare "U
nda hëna", dorëshkrim.*

ZIJARET NË QERBELA

OFERTË SPECIALE

PRISHTINË – STAMBOLL – QERBELA

VAZHDON NË MUAJIN SHTATOR 2019

BILETA E AEROPLANIT, VIZA, VIZITAT,
& HOTELI (PANSION I PLOTË).

VIZITA E VENDEVE SI:

QERBELA, NEXHEF, KUFE, BAGDAD, KADHIMIJE

Oferta përfshin vizitën e këtyre vendeve të shenjta turistike.

Qerbela

- Mauzoleu (tyrbja) dhe xhamia e Imam Husejnit
- Xhamia e Hazreti Abbasit dhe tyrbet e të gjithë shehidave të Qerbelasë
- Shetitje nëpër qytetin e Qerbelasë

Nexhef:

- Xhamia e madhe e Imam Aliut
- Xhamia dhe Mihrabi i martirizimit të Imam Aliut në Kuffe.
- Shtëpia dhe bunari i Imam Aliut në Kuffe.

Bagdad:

- Xhamia dhe mauzoleu i Hazreti Abdul-Kadir Xhejlaniut (themeluesi i tarikatit Kadiri)
- Xhamia dhe mauzoleu i Imam Ebu Hanifes (themeluesi i medh'hebit/shkollës juridike Henefi)

Basra:

- Xhamia dhe mauzoleu i Pirit Ahmed Rufai në Basra

TELEFON

+38344142038

VIBER

EMAIL

qerbela.ks@gmail.com



Zijaret ne Qerbela

